AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË NË ARSIMIN E LARTË

# RAPORTI I VLERËSIMIT TË JASHTËM

Programi i Studimit me Karakter Profesional

"Teknologji ushqimore", në profilet "Teknologji e pijeve dhe ujit", "Teknologji e produkteve bimore" dhe "Teknologji e produkteve shtazore"

i

Kolegjit Universitar "Qiriazi"

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm:

**Prof. Dr. Bizena Bijo**

**Prof. As. Rozeta Hasalliu**

Shkurt 2022

**Për Programin e Studimit me Karakter Profesional "Teknologji ushqimore", në profilet "Teknologji e pijeve dhe ujit", "Teknologji e produkteve bimore" dhe "Teknologji e produkteve shtazore"**

| Nr. | | |
|---|---|---|
| 1 | IAL aplikues: | Kolegji Universitar "Qiriazi" |
| 2 | Njësia bazë që e ofron: | Departamenti i Teknologjisë Ushqimore dhe Turizmit (Kolegji Profesional i Lartë) |
| 3 | Emërtimi i programit të studimit: | "Teknologji ushqimore", në profilet "Teknologji e pijeve dhe ujit", "Teknologji e produkteve bimore" dhe "Teknologji e produkteve shtazore" |
| 4 | Urdhëri/VKM i licencimit: | UMAS Nr. 451, datë 25.07.2018. |
| 5 | Urdhëri/VKM i riorganizimit: | - |
| 6 | Forma e regjistrimit të diplomës: | - |
| 7 | Urdhëri/VBA i akreditimit të parë: | - |
| 8 | Cikli i studimit: | Program me karakter profesional |
| 9 | Kohëzgjatja e programit të studimit: | 2 vite akademike |
| 10 | Kreditet në total (ECTS): | 120 ECTS |
| 11 | Forma e studimit: | Me kohë të plotë |
| 12 | Gjuha (shqip/tjetër): | Gjuha shqipe |
| 13 | Programi ofrohet në bashkëpunim me institucione të tjera: | - |
| 14 | Diplomë e përbashkët (shëno emërtimin): | - |
| 15 | Diplomë e dyfishtë (shëno emërtimin): | - |
| 16 | Niveli në kornizën kombëtare të kualifikimeve: | Niveli 5 |
| 17 | Stafi akademik PAE/PAK për programin e studimit: | 8 PAE/3 PAK |
| 18 | Numri i studentëve: | v.a 2019-2020: 25 studentë<br>v.a 2020-2021: 13 studentë |
| 19 | Komente / të tjera: | - |

**PËRMBLEDHJE E TË DHËNAVE PËR PROGRAMIN NË PROCES TË VLERËSIMIT TË JASHTËM**

Kolegji Universitar "Qiriazi", është një institucion universitar privat që e ushtron aktivitetin e vet pas liçencimit me VKM nr 274, dt 10.05.2006 fillimisht si Shkollë e Lartë Universitare "Sevasti dhe Parashqevi Qiriazi " e në vazhdim pas Urdhërit nr. 92, dt 1.03.2017, të MASR si Kolegji Universitar Qiriazi (KUQ).

KUQ ka në përbërje të vet 4 njësi akademike që janë Fakulteti i Drejtësisë, Fakulteti i Ekonomisë, Fakulteti i Edukimit, Shkencave Sociale dhe Sportit si dhe Kolegji Profesional i lartë (KLP).

Me Udhëzimin nr. 451, dt 25.07.2018, të MASR, KLP hapi programin e studimit dy vjecar **"Teknologji ushqimore" me tre profile studimi përkatësisht: Teknologji e Pijeve dhe Ujit, Teknologji e Produkteve Shtazore dhe Teknologji e Produkteve Bimore.**

Programi i Tekonologjisë Ushqimore me tre profilet e tij ofrohet nga Departamenti i Teknologjise Ushqimore dhe Turizmit që është njësi bazë e KLP.

Programi i studimit ofrohet ne 4 semestra, nga të cilat semestri i IV është semestri, ku zhvillohet praktika profesionale 5 javore. Tre semtrat e parë kanë të njëjtin kurrikul dhe plan mësimor për të tre profilet, ndërsa në semestrin e katërt (10 javë) ofrohen disiplina formuese të ndryshme në funksion të profilit të studimit.

Stafi akdemik i Departamentit të Teknologjisë Ushqimore dhe Turizmit përbëhet nga 5 pedagogë efektivë të brendshëm dhe katër pedagogë të ftuar me kontratë. Stafi i bredshëm ka në përbërje të vet një Profesor, tre Doktor dhe një MSc, ndërsa stafi i ftuar ka një Prof.as dhe tre MSc.

Numri i studentëve në vitin akademik 2018-2019 ishte 34, ndërsa në vitin akademik 2019-2020 ishte 16. Kalueshmëria e studentëve në vitin akademik 2019-2020 ishte 83%, ndërsa nota mesatare 6,9.

Në funksion të zhvillimit të procesit mësimor brenda KUQ ka tre salla leksionesh, 7 klasa për seminare, një laborator për zhvillimin e lëndëve Kimi dhe atyre teknologjike, 1 sallë informatike, dy salla bibloteke, një sallë interneti si dhe mjedise të tjera clodhëse për studentët.

Për kryerjen e praktikës profesionale KLP ka lidhur marrëveshje bashkëpunimi me 15 institucione private (Ndërmarje përpunuese të ushqimit dhe pijeve). Po kështu KUQ ka marrëveshje edhe me institucione universitare si psh Universiteti Bujqësor i Tiranës, që ofron disa programe studimi të ngjashme.

Nga studentët e diplomuar në KLP rezulton se deri në vitin 2021 janë punësuar në profilet e punës sipas diplomimit të tyre, 11 studentë.

**PËRSHKRIMI I PROCESIT TË VLERËSIMIT TË JASHTËM;**

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm i cili u përzgjodh për vlerësimin e këtij programi përbëhet nga Prof. Bizena Bijo dhe Prof. Asoc. Dr. Rozeta Hasalliu në udhëheqjen e Koordinatores teknike të ASCAL Msc. Arjana Alija. Raporti i vlerësimit të jashtëm u hartua nga shqyrtimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion nga institucioni pranë ASCAL dhe nga takimet me stafin akademik, studentët, dhe përfaqësues të zyrave të ndryshme, me qëllim akreditimin e programit të studimit dy vjecar "Teknologji ushqimore" me tre profile studimi përkatësisht: Teknologji e Pijeve dhe Ujit, Teknologji e Produkteve Shtazore dhe Teknologji e Produkteve Bimore.

Në bazë të Agjendës së vizitës të Grupit të Vlerësimit të Jashtëm për Vlerësimin dhe Akreditimin e programit të studimit: dy vjecar "Teknologji ushqimore" me tre profile studimi përkatësisht: Teknologji e Pijeve dhe Ujit, Teknologji e Produkteve Shtazore dhe Teknologji e Produkteve Bimore, të Kolegjit Universitar "Qirjazi", të miratuar nga të gjitha palët e përfshira u realizuan këto veprimtari të planifikuara.

Takimi i parë u realizua midis Grupit të Vlerësimit të Jashtëm (Prof. Bizena Bijo dhe Prof. As. Rozeta Hasalliu dhe Koordinatores Teknike të ASCAL (Msc. Arjana Alija), ku u diskutua për mënyrën se si do të zhvilloheshin takimet e planifikuara. Takimi i dytë u realizua me Drejtorin e Kolegjit Prof. Abdyl Sinani dhe Përgjegjësin e Departamentit Dr. Blerta Turani. U diskutua në lidhje me detyrën e Drejtorit dhe Përgjegjësit të Departamentit në mbarëvajtjen e Programit Studimor. Gjithashtu, ata u përgjigjën pyetjeve të përgatitura nga grupi i vlerësimit të jashtëm. Takimi i tretë u realizua me Anëtarët e GVB-së, ku u diskutua në lidhje me dokumentacionin e dorëzuar. Takimi i katërt u realizua me Stafin akademik të brendshëm dhe të jashtëm për këtë program studimi, ku u diskutua në lidhje me Syllabuset për secilin modul, financimin nga ana e departamentit, për aktivitete që ndihmojnë në kualifikimin e tyre, etj. Takimi i pestë u realizua me Studentët e vitit të parë, të dytë të këtij programi. Në këtë takim u diskutua për mënyrën sesi u njohën me këtë program studimi dhe përse e zgjodhën, mënyrën e regjistrimit, mënyrën e zhvillimit të mësimit, mendimin e tyre për pedagogët e lëndëve, mbështetja nga ana e pedagogëve për pjesëmarrjen e tyre në aktivitete të ndryshme, efikasitetin e përdorimit të Bibliotekës dhe për kërkesat e tyre ndaj departamentit

Takimi i gjashte u realizua me Përfaqësues të Zyrave/ Drejtorive (Drejtorinë e Burimeve Njerëzore, Zyrën e marrëdhënieve me jashtë), ku u diskutua për rolin e secilës zyrë në mbarëvajtjen e Programit të Studimit. Takimi i shtatë u realizua me Punonjësen e sekretarisë për programin e studimit: ku u njohëm me detyrat e saj, përshembull me mënyrën e regjistrimit të studentëve, zhvillimin e provimeve, me regjistrat e mbajtjes së të dhënave. Në fund të takimeve u bë vizita e ambjenteve te mesimdhënies dhe laboratorëve të Informatikës dhe të Teknologjisë Ushqimore, si dhe të Bibliotekës.

Gjatë takimeve u kërkua nga Grupi i Vlerësimit të Jashtëm dokumentacion shtesë.

Takimi i fundit u realizua midis Grupit të Vlerësimit të Jashtëm dhe Koordinatores Teknike të ASCAL, ku u diskutua mbi ecurinë e procesit të vlerësimit dhe për dokumentacionin shtesë, ku Koordinatorja Teknike ndihmoi në plotësimin e dokumentacionit.

Kolegjit Universitar "Qiriazi" është njohur me Draft-Raportin e Vlerësimit të Jashtëm më datë 07.02.2022, përmes sistemit AMS, si dhe në formë zyrtare me anë të shkresës me Nr. 75 Prot, datë 07.02.2022. IAL përcolli komentet përmes AMS më datë 10.02.2022 dhe me shkresë zyrtare në datë 14.02.2022 me Nr. 23 Prot, datë 10.02.2022.

**GVJ pasi u njohën me komentet e institucionit mbi Draft- Raportin sqaron si vijon:**

Në vijim të reagimit ndaj komenteve të përgatitura nga KPL, ekspertët shprehin kënaqësinë në mirëkuptimin që ka treguar institucioni karshi raportit të përgatitur prej tyre. Mendimi i ekspertëve për komentet e KPL është si në vazhdim.

- Sa i takon Standardi I.1, "**Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi me karakter profesional në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij dhe në përputhje me nevojat e kërkesat e tregut të punës".** dhe përkatëtësisht kriterit 4 dhe 5 , ku ekspertët kanë vërejtur se :

    1. Nuk jepen të dhëna konkrete për nevoja të teknikëve në tre profilet e implementuara dhe
    2. Mund të kishte një informacion më të detajuar statistikor për tipet e ndërmarjeve të industrisë ushqimore në vend,

  I jemi referuar *aneksit 3.9, (Studimi për tregun e punës përpara hapjes së programit),* por konstatuam që informacioni që ju referoni i takon vitit 2008, pra e konsiderojmë një informacion jo të përditsuar. Informacioni kemi gjykuar do të ishte më realist nëse do të kishtë shifra konkrete të ndërmarjeve të industrisë së produkteve shtazore, të ndërmarjeve të pijeve dhe ujit si dhe produkteve bimore. Është e vërtetë që KPL është i vetmi institucion privat që ofron këto programe studimi, por nga ana tjetër ka shumë universitete publike që ofrojnë këto programe të nivelit Bachelor. Numri i studentëve që diplomohen në këto institucione, është tepër i madh.

  **Prandaj mendojmë që kjo vërejtje të mbetet në raportin e paraqitur nga ekspertët**

- Sa i takon Standardit I.2 **"Institucioni i arsimit të lartë siguron marrëdhënie bashkëpunimi brenda institucionit dhe me institucione, kompani, palë të treta, aktorë të biznesit vendas dhe/ose të huaj në funksion të realizimit të programit të studimit, dhe në përputhje me fushën dhe specifikën e këtyre të fundit"** dhe përkatësisht kriterit **1,** ku ekspertët kanë vërejtur se :

    1. Rregullorja KUQ **(aneksi** *1.3, Rregullorja e KUQ*) e miratuar ne vitin 2020, e shtrin efektin e saj ne vitin 2016-2017. (Rregullorja nuk mund të ketë efekte paravepruese.). Ky fakt është sanksionuar në nenin nr 110 të Rregullores së KUQ, ku citohet që ajo (Rregullorja) e shtrin efektin nga viti 2016-2017 dhe në fund rregullorja mbyllet me vendimin e Senatit nr. 84, dt: 18.11.2020.

Mendojmë që në Rregullore duhet të ndaheshin më vete nenet e përditsuara me vendimin nr 84, dt: 18.11.2020 sepse paraqitja në këtë formë, vështirëson zbatimin ndër vite të saj.

**Prandaj konstatimi i ekspertëve mendojmë se duhet të qëndrojë**

2. E ritheksojmë se në RVV, referuar Rregullores se KUQ, *(aneksi nr 1.3 ne kreun II*), nuk gjejmë të shprehur marrëdhënien e bashkëpunimit brenda njësive por gjejmë detaje mbi detyrat që kanë autoritet drejtuese Po ashtu *aneksi 3.15,* nuk demostron bashkepunimin midis njesive te KPL, por vetëm përbërjen e stafit akademik të TU, titujt, gradat, pedagogët efektiv dhe ata me kontratë dhe raportet në numra midis tyre. Gjithashtu në: An.*_2_5_Raporti i analizës së punës vjetore (2019-2020) të KPL; An._3_11_Raporti i fundit i përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit pë programin e studimit TU.; An._3_15_Të dhëna tabelore për personelin akademik në programin TU (2020-2021)*, nuk gjejmë të shprehur qartë bashkëpunimin, midis njësive të KPL.

**Prandaj konstatimi i ekspertëve mendojmë se duhet të qëndrojë.**

- Sa i takon Kriterit 2, të po të njëjtit standart si më sipër: KPL ka paraqitur një listë të bashkëpunimit me institucione, ku kemi vërejtur që një pjesë e këtyre bashkëpunimeve është në kuadër të KUQ dhe jo posaçërisht të KPL.

KPL ka realisht marrëveshje bashkëpunimi me biznese të fushës reth 15.

Ekspertët konstatuan që në fund të komenteve tona i jemi referuar një aneksi të gabuar, megjithëse konfirmojmë që komentet në RVJ, i kemi korrektesisht referuar aneksit *An. 3.10.*

**Ekspertët në RVJ vendosen në fund të komenteve: An._3_10_Tabelë përmbledhëse me institucionet bashkëpunuese për programin e studimit TU dhe për praktikën profesionale**

**Gjithsesi ekspertët mendojnë se konstatimi i tyre qëndron.**

- Sa i takon Standardit I.3 **"Programet e studimeve organizohen në përputhje me parashikimet ligjore e përcaktimet nënligjore kombëtare në fuqi dhe Kuadrin Evropian e Shqiptar të Kualifikimeve për këto programe studimi",** përkatësisht kriterit 5, ekspertët kanë konstatuar;

1. Në të dhenat mbi stafin akademik, *aneksi 2.7, dhe 3.14*, paraqiten lista emërore të stafit efektiv dhe atij me kontratë për vitin akademik 2020-2021, me numra të ndryshëm.

KPL ka komentuar se bëhet fjalë për dy modalitete të ndryshme (stafi në përbërje të DTH dhe në tabelën tjetër stafi që zhvillon mësim në DTH)

Ekspertët nuk bien dakort me komentet e KPL mbasi në tabelën e stafit akademik të DTH, ka pedagogë me kontratë si psh M Memajdini dhe F Kushta, të cilët edhe pse janë pjesë e departamentit nuk zhvillojnë mësim në këtë departament, ashtu sikurse E Orhani (pedagog i brendshëm) edhe pse është efektiv i DTH, nuk zhvillon mësim në këte departament. Pra në listat e paraqitura të stafit, ka konfuzion dhe mospërputhje.

**Ekspertët mendojnë se konstatimi i tyre është i saktë.**

- Sa i takon standartit Gjithashtu **Standarti II.1 "Programet e studimeve me karakter profesional janë të detajuara, informuese, të strukturuara dhe organizuara në përputhje me parashikimet dhe objektivat formuese të programeve të këtij niveli dhe mundësitë e punësimit" permbushet kryesisht** mbasi ekspertët gjykojnë:

    1. Duhet të ishte treguar më kujdes në emërtimin e disa lëndëve në kurrikul, që ato të shprehnin përmes emërtimit të tyre thelbin dhe funksionin në formimin e kurrikulës. Kështu p.sh lënda: "Vera" mund të emërtohej "Teknologjia e prodhimit të verës". Po ashtu lënda "Uji, Fruta perimeve dhe lëngjet" mund të trajtohej e ndarë në dy disiplina formuese, për shkak të rëndësisë dhe peshës që mund të zërë secila në kurrikul.

Referuar standartit II.2 **"Struktura, plani mësimor dhe shpërndarja lëndore e programeve të studimit me karakter profesional, është në përputhje me objektivat formuese, rezultateve të të nxënit sipas Kuadrit Kombëtar dhe Evropian të Kualifikimeve dhe kërkesave të tregut të punës për këto programe."** ekspertët gjykojnë se:

Përsëri në kriterin 3, referuar *aneksit 3.5.2* citohet se lëndët ndërdisiplinore zenë peshë 11% nga 12 % që kërkohet në VKM Nr.41.dt 24.01.2018 (I ndryshuar)

**Referuar problematikave të cituara si më sipër, ekspertët mendojnë se kjo fushë " permbushet kryesisht"**

## Vlerësimi i Programit të Studimit me karakter profesional "Teknologji ushqimore", në profilet "Teknologji e pijeve dhe ujit", "Teknologji e produkteve bimore" dhe "Teknologji e produkteve shtazore"

### I. OFRIMI, ORGANIZIMI DHE DREJTIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMIT ME KARAKTER PROFESIONAL

| **Standardi I.1**<br>**Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi me karakter profesional në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij dhe në përputhje me nevojat e kërkesat e tregut të punës.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi** |
| **Kriteri 1.** Programet e studimeve hartohen dhe ofrohen në përputhje me qëllimet dhe misionin e institucionit, në përshtatje dhe në zbatim të strategjisë për zhvillim të vetë institucionit. | Programi i studimit me karakter profesional "Teknologji ushqimore", në profilet "Teknologji e pijeve dhe ujit", "Teknologji e produkteve bimore" dhe "Teknologji e produkteve shtazore" është organizuar në përputhje me parashikimet e nenit 72 të ligjit nr. 80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë". Ky program është organizuar sipas sistemit të Arsimit të Formimit Profesional, nivelit 5 të Kornizës Shqipëtare të Kualifikimeve. Programi i studimit është 2 vjeçar (me kohë të plotë, në gjuhën shqipe) ofron 120 ECTS. Institucioni garantọn që programet e studimit që ai ofron nuk bien ndesh me interesat kombëtare. Ky fakt sanksionohet ne Statutin, Strategjine e KUQ si dhe Strategjine Programit te studimit KPL.<br><br>An._1_1_Statuti i KUQ.pdf<br>An._1_2_Plani Strategjik i zhvillimit të KUQ.pdf<br>An._3_2_Plani strategjik i zhvillimit të programit TU.pdf |
| **Kriteri 2.** Statuti dhe rregullorja e institucionit duhet të përcaktojnë qartë drejtimet prioritare akademike të tij dhe të demonstrojnë se programet e studimit hartohen dhe ofrohen në përputhje dhe në zbatim të këtyre të fundit. | Nga shqyrtimi i dokumentacionit të dorëzuar, konstatojmë së Statuti dhe Rregullorja e programit të studimit, kanë të përcaktuar qartë drejtimet prioritare akademike.<br>Programi i studimit Teknologji Ushqimore me tre profile synon të ruajë dhe konsolidojë vlerat akademike që sanksionohen tek misioni i KUQ si dhe në Strategjinë e institucionit dhe programit të studimit.<br>An._1_1_Statuti i KUQ.pdf<br>An._1_3_Rregullore e KUQ.pdf |
| **Kriteri 3.** Programet e studimeve ofrohen në përputhje me fushat e drejtimet akademike të institucionit, si dhe fushën akademike të njësisë | Programet e studimit janë hartuar në përputhje me misionin e institucionit , si dhe fushën e veprimtarisë së KPL, por Plani strategjik i këtij kolegji nuk është i azhornuar me ndryshimet që kanë ndodhur në vitin 2019, kur është aprovuar edhe programi i |

| | |
|---|---|
| kryesore/kolegjit profesional dhe atë të njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit. | studimit Hoteleri Turizëm dhe mbi këtë bazë ka ndryshuar edhe emërtimi i departamentit që e zbaton këtë program dhe që tashmë quhet Dep i Teknologjisë Ushqimore dhe Turizmit<br>An_1_1_2_U_MASR_Hapja e KPL dhe programeve TI&TU&HT.pdf<br>An._2_2_Plani strategjik i zhvillimit të KPL 2018-2022.pdf<br>An._2_3_Rregullore Kolegjit Profesional të Lartë1.pdf<br>An._3_3_Rregullore e Departamentit TUT.pdf |
| **Kriteri 4.** Propozimi, hartimi dhe realizimi i programit të studimit me karakter profesional mbështetet në studime të mirëfillta mbi tregun lokal e kombëtar të punësimit për këto programe. | Në dokumentacionin e paraqitur nga institucioni ka një studim mbi tregun e punës me te dhëna të përgjithshme të përftuara nga institucione shtetërore kryesisht, por gjithsesi nuk justifikohet në këtë studim nevoja e profilizimit të këtij programi me tre profile. Nuk jepen të dhëna konkrete për nevoja të teknikëve në tre profilet e implementuara. Nuk gjejmë dokumentacion shtese sikurse thuhet në fund të studimit, mbasi është hapur programi TU.<br>An._3_5_Dosja e programit të studimit TU.pdf<br>An._3_8_Studimi për tregun e punës përpara hapjes së programit (dokument i procesit të hapjes).pdf |
| **Kriteri 5.** Gjatë realizimit të programit të studimit, nga pranimi në diplomim dhe pas daljes së studentëve në punë, zhvillohen studime periodike mbi tregun e punës, ndryshimet përkatëse dhe punësimin e studentëve. | Studimi i kryer nga KU, është studim i mbështetur kryesisht në statistika dhe dokumenta shtetërore dhe më pak në hulumtime të kryera mbi bizneset specifike të industrisë ushqimoreqë operojmë me tre profilet e studimit. Mund të kishte një informacion më të detajuar statistikor për tipet e ndërmarjeve të industrisë ushqimore në vend<br>An._3_9_Studimi periodik për tregun e punës_TU.pdf |
| **Kriteri 6.** Studimet paraprake dhe periodike të tregut të punës për programet me karakter profesional duhet të përfshijnë të dhëna nga komunikimi zyrtar me punëdhënësit e fushës, kërkesat dhe nevojat e tyre, mundësitë e punësimit të studentëve, të dhëna mbi punësimin real të studentëve të diplomuar dhe zhvillimet e pritshme në sektorin përkatës. | Në studim thuhet se KPL ka nënshkruar marrëveshje me një sërë biznesesh, ku studentët kryejnë praktikat mësimore dhe profesionale që janë një mundësi e mire për punësimin e ardhshëm të tyre. Ka 11 studentë të diplomuar në profilet e studimit Teknologji ushqimore që janë punësuar në biznese të ndryshme. (tab 31.1 tek dokumentat shtesë)<br>An._3_9_Studimi periodik për tregun e punës_TU.pdf<br>An._3_10_Tabelë përmbledhëse me institucionet bashkëpunuese për programin e studimit TU dhe për praktikën profesionale.pdf |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | **X** | |

| Standardi I.2<br><br>**Institucioni i arsimit të lartë siguron marrëdhënie bashkëpunimi brenda institucionit dhe me institucione, kompani, palë të treta, aktorë të biznesit vendas dhe/ose të huaj në funksion të realizimit të programit të studimit, dhe në përputhje me fushën dhe specifikën e këtyre të fundit.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi** |
| **Kriteri 1.** Për hartimin, mbikëqyrjen dhe mbarëvajtjen e programit, siguron marrëdhënie të frytshme bashkëpunimi brenda institucionit nëpërmjet ndarjes së detyrave mes njësive e personelit, marrjes së përgjegjësive respektive dhe analizës së vazhdueshme të punës së tyre. | Rregullorja KUQ e miratuar ne vitin 2020, e shtrin efektin e saj ne vitin 2016-2017. (Rregullorja nuk mund te ketë efekte prapavepruese.)<br><br>Ne rregulloren e KUQ, ne kreun II, që citohet në raport nuk gjejmë të shprehur marrëdhënien e bashkëpunimit brenda njësive sikurse citohet në raport por gjejmë detyrimet që kanë autoritet drejtuese Dok 3.15, nuk demostron bashkepunimin midis njesive te KLP por vetem përbërjen e stafit akademik të TU, titujt, gradat pedagoget efektive dhe ata me kontrate dhe raportet midis tyre. Stafi i departamentit eshte i përbërë nga 5 anëtarë efektivë dhe 4 anëtarë të ftuar me kontratë.<br><br>An._1_3_Rregullore e KUQ.pdf<br>An._2_3_Rregullore Kolegjit Profesional të Lartë1.pdf<br>An._2_4_Rregullorja e Asamblesë së KPL.pdf<br>An._2_5_Raporti i analizës së punës vjetore (2019-2020) të KPL.pdf<br>An._3_11_Raporti i fundit i përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit pë programin e studimit TU.pdf<br>An._3_15_Të dhëna tabelore për personelin akademik në programin TU (2020-2021).pdf |
| **Kriteri 2.** Për realizimin e objektivave të procesit mësimor, formimin teorik e praktik të studentëve, institucioni vendos marrëdhënie afatgjata e të qëndrueshme bashkëpunimi me institucionet homologe brenda dhe/ose jashtë vendit, me punëdhënës vendës, aktorë të biznesit vendës dhe/ose të huaj. | KLP ka paraqitur nje liste te bashkepunimit me institucione analoge universitare dhe jo vetem brenda por dhe jashte vendit. Por theksojme që një pjesë e këtyre bashkëpunimeve është në kuadër të KUQ dhe jo posacerisht të KLP, KLP ka marrëveshje bashkëpunimi me biznese të fushës reth 15.<br><br>An._3_10_Tabelë përmbledhëse me institucionet bashkëpunuese për programin e studimit TU dhe për praktikën profesionale.pdf<br>An._3_15_Të dhëna tabelore për personelin akademik në programin TU (2020-2021).pdf<br>12. 10. Marreveshje me UBT.pdf( Dok shtese)<br>4. 2. Marreveshjet e bashkpunimit ne kuader te programit.pdf( dok shtese) |
| **Kriteri 3.** Në mënyrë periodike, njësia përgjegjëse për programin e studimit harton raporte analitike të përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të realizimit të programeve të studimeve. | KLP ka paraqitur një raport të përfitimit që ka pasur në kuadër të marrëveshjeve të bashkëpunimit, në funksion të realizimit të programit të studimit, por fokusi në këtë raport është vendosur kryesisht tek pjesëmarrja e stafit në seminare, konferenca, simpoziume dhe më pak tek pjesmarja e studenteve ne aktivitete të kësaj natyre. |

| | |
|---|---|
| | An._3_11_Raporti i fundit i përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit pë programin e studimit TU.pdf<br>An._3_12_Analizë vjetore e Departamentit TU.pdf |
| **Kriteri 4.** Institucioni vendos marrëdhënie zyrtare e bashkëpunon me punëdhënësit për kryerjen dhe mbikëqyrjen e praktikës, në varësi të natyrës specifike të programeve të studimeve që ofrojnë. | Institucioni ka vendosur marrëdhenie bashkepunimi me 15 biznese me natyre specifike te programit të TU. Në funksion të realizimit të praktikës profesionale KLP ka edhe një rregullore specifike.<br>An._3_6_Rregullore e Praktikës Mësimore Profesionale.pdf<br>An._3_10_Tabelë përmbledhëse me institucionet bashkëpunuese për programin e studimit TU dhe për praktikën profesionale.pdf<br>An._3_11_Raporti i fundit i përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit pë programin e studimit TU.pdf |
| **Kriteri 5.** Institucioni ndërmerr iniciativa specifike në mbështetje të sipërmarrjes dhe punësimit të studentëve. | Iniciativa konkrete të sipërmarjes dhe punësimit pasqyrohen në raportin e përfitimit, por duhej të theksohej më shumë në panairet e karrierës.<br>An._3_11_Raporti i fundit i përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit pë programin e studimit TU.pdf |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | **X** | |

| **Standardi I.3**<br>**Programet e studimeve organizohen në përputhje me parashikimet ligjore e përcaktimet nënligjore kombëtare në fuqi dhe Kuadrin Evropian e Shqiptar të Kualifikimeve për këto programe studimi.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi** |
| **Kriteri 1.** Programet e studimeve janë të organizuara në lëndë/module dhe të vlerësuara në kredite, në përputhje me legjislacionin vendës në fuqi dhe sipas Sistemit Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS). | Struktura dhe përmbajtja e programit "Teknologji ushqimore", në profilet "Teknologji e pijeve dhe ujit", "Teknologji e produkteve bimore" dhe "Teknologji e produkteve shtazore", është në përputhje me ligjin nr. 80/2015, si dhe aktet nënligjore që rrjedhin prej tij. Programi është organizuar mbi bazën e Sistemit Evropian të Transferimit të Krediteve. Në planin mësimor të paraqitur programi është i organizuar në kredite në përputhje me legjislacionin në fuqi. Eshte e paqartë se si janë llogaritur kreditet për provimin përfundimtar, mbasi nuk sqarohet mirë trinomi dije-njohuri-kompetencë.<br>An._3_5_1_Plani Mësimor i programit të studimit TU, 2020-2021.pdf<br>An._3_5_2_Kreditet sipas veprimtarive formuese për programin e studimit TU, 2020-2021.pdf |

| | |
|---|---|
| | An._3_13_Të dhëna për kodifikimin e programit të studimit TU.pdf |
| **Kriteri 2.** Programet e studimeve me karakter profesional synojnë përftimin e njohurive gjithë përfshirëse të specializuara teorike dhe praktike brenda një fushe punësimi në një llojshmëri të gjerë profesionesh e specialitetesh. | Programi i studimit TU me tre profile i organizuar në 4 semestra dhe me 120 kredite, ju ofron studenteve mundesi punesimi në llojshmeri profesionesh. Tre profilet ndahen nga njeri tjetri vetem nga lëndë karakterizuese që kryhen ne semestrin 4, në rastin e Produkteve shtazore vetem dy lendë, ndërsa në profilet e tjera tre lëndë. Në kurrikul nuk është ofruar tek profili Produktet shtazore një lënde e tretë, ndoshta ajo që trajton vezët, mjaltin, etj.<br>An._1_1_2_U_MASR_Hapja e KPL dhe programeve TI&TU&HT.pdf<br>An._2_3_Rregullore Kolegjit Profesional të Lartë1.pdf<br>An._3_5_Dosja e programit të studimit TU.pdf<br>An._3_5_3_Programi mësimor për TU, 2020-2021.pdf |
| **Kriteri 3.** Programet e studimit me karakter profesional synojnë pajisjen e studentëve me një sërë aftësish njohëse dhe praktike gjithëpërfshirëse që nevojiten për të zgjidhur në mënyrë krijuese probleme të karakterit profesional praktik. | Syllabuset e lëndëve janë të formatuara sipas VKM mbi elementët e programit mësimor. Vlerësimi i studentëve gjatë vitit bëhet me 40 pike ndërsa provimi me 60 pikë. Studentët zhvillojnë detyra kursi dhe provime të ndërmjetme.<br>An._2_3_Rregullore Kolegjit Profesional të Lartë1.pdf<br>An._3_2_Plani strategjik i zhvillimit të programit TU.pdf<br>An._3_4_Rregullore e Programit të Studimit TU.pdf<br>An._3_17_Syllabuset e lëndëve të ofruara në vitin 2020-2021.pdf<br>5.3. Detyre Kursi .pdf (dok shtesë)<br>6.3. Provim i ndermjetem.pdf (dok shtesë) |
| **Kriteri 4.** Programet e studimit me karakter profesional synojnë zhvillimin e kompetencave për menaxhimin dhe mbikëqyrje në kuadrin e veprimtarive profesionale dhe orientimin e duhur në situata të ndryshme e të ndryshueshme. | KLP në përgjigje të realizimit të këtij kriteri duhej të mbështetej kryesisht në realizimin e praktikave mësimore dhe asaj profesionale, prandaj duhej ti referohej planit mësimor, syllabuseve të lëndëve karakterizuese , ku të tregonte peshën që zënë në kurrikul praktikat mësimore në laboratore apo vizitat në bizneset e ndryshme të industrisë ushqimore. Vlerësimi i praktikës profesionale mendoj se duhet të jetë me notë për të vendosur studentët në një angazhim më të mirë të tyre.<br>An._2_3_Rregullore Kolegjit Profesional të Lartë1.pdf<br>An._3_3_Rregullore e Departamentit TUT.pdf<br>An._3_4_Rregullore e Programit të Studimit TU.pdf |
| **Kriteri 5.** Institucioni/njësia kryesore/kolegji profesional dhe njësia bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush kërkesat ligjore dhe standardet e cilësisë të organizimit, strukturës akademike dhe numrit e shkallës së kualifikimit të stafit akademik. | Në të dhenat mbi stafin akademik, tab 2.7, lista emërore e stafit efektiv dhe atij me kontratë për vitin akademik 2020-2021, na paraqitet në tabelë të ndryshme me nr të ndryshëm. Njëherë e gjejmë në tabelë numrin e stafit në departamentin e TUT me 5 pedagogë dhe njëherë me 8 pedagogë. Sa i takon kualifikimit, përbërja e stafit është konform zbatimit të LAL. Në raportin e Vetëvlerësimit na paraqiten akte ligjore të hapjes së njësive të ndryshme brenda KUQ si psh dokumenti i akreditimit të këtij institucioni (2 vjet) i cili ka pasur një afat vlefshmërie deri 10.05.2020.<br>An._1_1_1_Akte nënligjore për KUQ.pdf |

| | |
|---|---|
| | An._2_7_Të dhëna tabelore për stafin akademik të departamentet e KPL(2020-2021)1.pdf<br>An._3_14_Të dhëna tabelore për stafin akademik në departamentin TUT (2020-2021).pdf |
| **Kriteri 6.** Programet e studimeve kanë objektiva të përcaktuar qartë për formimin profesional të studentëve, ku përfshihen dijet, aftësitë dhe kompetencat profesionale që duhet të fitojnë studentët në përfundim të programit të studimit dhe që e karakterizojnë profilin profesional të programit. | Në dosjen e paraqitur nga institucioni ka një paraqitje jo tëresisht korrekte të syllabuseve të lëndëve përkatëse ku rezultatet e të nxënit janë formatuar mire. Në syllabuse mungojnë temat e praktikave apo laboratorëve. Objektivat janë paraqitur qartësisht edhe në Rregulloren e programit të studimit si dhe në dosjen e programit të studimit.<br>An._3_4_Rregullore e Programit të Studimit TU.pdf<br>An._3_5_Dosja e programit të studimit TU.pdf<br>An._3_17_Syllabuset e lëndëve të ofruara në vitin 2020-2021.pdf |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | **X** | |

| **Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës I** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | **X** | |

## II. STRUKTURA DHE PËRMBAJTJA E PROGRAMEVE TË STUDIMIT ME KARAKTER PROFESIONAL

| **Standardi II.1**<br>**Programet e studimeve me karakter profesional janë të detajuara, informuese, të strukturuara dhe organizuara në përputhje me parashikimet dhe objektivat formuese të programeve të këtij niveli dhe mundësitë e punësimit** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi** |
| **Kriteri 1.** Programet e studimit të ciklit të parë, përmbajnë dhe japin informacionet e nevojshme për objektivat formues, rezultatet e pritshme të të nxënit, organizimin, strukturën, përmbajtjen, fushat e mundshme të punësimit apo të dhëna reale të punësimit të studentëve të diplomuar në këto programe. | Gjatë shqyrtimit të programeve mësimore (An.-3-17) jepen informacionet e nevojshme për objektivat formues, rezultatet e pritshme të të nxënit, organizimin, strukturën, përmbajtjen, fushat e mundshme të punësimit, nga studimi i tregut (An.-3-8; An.-3-9), gjithashtu jepen të dhëna reale të punësimit të studentëve të diplomuar ne këtë program.<br>An._3_17_Syllabuset e lëndëve të ofruara në vitin 2020-2021.pdf<br>An._3_8_Studimi për tregun e punës përpara hapjes së programit (dokument i procesit të hapjes).pdf |

| | |
|---|---|
| | An._3_9_Studimi periodik për tregun e punës_TU.pdf |
| **Kriteri 2.** Programet e studimit janë të organizuara në module/lëndë e aktivitete formuese, të vlerësuara me kredite, të ndara në vite e semestra e që janë në përputhje me përcaktimet vendëse e evropiane në fuqi. | Programi i studimit është i organizuar në module/lëndë e aktivitete formuese, të vlerësuara me kredite, i organizuar në dy vite akademike me nga 60 kredite për secilin vit akademik (An.-3-5-1) që përbëjnë gjithsej 120 kredite, të ndara në semestra e që janë në përputhje me Ligjin e arsimit të lartë Nr.80/2015" Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në republikën e Shqipërisë" datë 22. 07.2015, për Kolegjin profesional të lartë, neni 21 pika 3. Lendet baze A zene 15 % (18 kredite), Karakterizuese B 55% (66 kredite), Ndersiplinore C 11% (13 kredite), Plotesuese D 15% (18 kredite), Detyruese mbyllese 4 % (5 kredite) (An.-3-5-2).<br><br>An._3_5_1_Plani Mësimor i programit të studimit TU, 2020-2021.pdf<br><br>An._3_5_2_Kreditet sipas veprimtarive formuese për programin e studimit TU, 2020-2021.pdf |
| **Kriteri 3.** Programet e studimit përmbajnë planin mësimor, ku përfshihen informacionet e nevojshme për ngarkesën mësimore, orët në auditor, frekuentimin/ndjekjen e programit, vlerësimin e dijeve, aktivitete specifike etj. | Programi i studimit përmban planin mësimor (An_3.5-3, An._3-3-1), ku përfshihen informacionet e nevojshme për ngarkesën mësimore, orët në auditor, frekuentimin/ndjekjen e programit, vlerësimin e dijeve apo aktivitete specifike në bazë të VENDIMIT Nr. 41, datë 24.1.2018 "PËR ELEMENTET E PROGRAMEVE TË STUDIMIT TË OFRUARA NGA INSTITUCIONET E ARSIMIT TË LARTË".<br><br>Per nje kredit studenti zhvillon 25 ore mesimore pune, dhe per 60 kredite ne vit zhvillon 1500 ore mesimore ne auditor ose pune te pavarur ose per te dy vitet 120 kredite 3000 ore mesimore ne auditor dhe pune te pavarur.<br><br>An._3_5_3_Programi mësimor për TU, 2020-2021.pdf<br><br>An._3_5_1_Plani Mësimor i programit të studimit TU, 2020-2021.pdf |
| **Kriteri 4.** Programet e studimit përmbajnë syllabuset e detajuara për secilën lëndë, për praktikat, ushtrimet apo orët e laboratorit, si dhe të gjithë komponentët e aktivitetet formuese të programit të studimit. | Programet e studimit përmbajnë syllabuset (An._3_17) e detajuara për secilën lëndë, për praktikat, ushtrimet apo orët e laboratorit, si dhe të gjithë komponentët e aktivitetet formuese të programit të studimit, bashkë më literatuën përkatëse për secilën lëndë.<br><br>Nga vizita ne Departament u be e njohur dhe planet kalendare per praktikat profesionale, nw te cilat jepen datat e zhvillimit dhe temat perkatese te zhvillimit te praktikave profesionale. (An._4)<br><br>An._3_17_Syllabuset e lëndëve të ofruara në vitin 2020-2021.pdf<br><br>4. Plan kalendar per zhvillimin e praktikave profesionale per tre profilet.pdf |

| | |
|---|---|
| **Kriteri 5.** Struktura dhe organizimi i programit të studimit është mjaftueshmërisht fleksibël për të mundësuar formimin e studentëve përgjatë programit dhe në përshtatje me punësimin. | Struktura dhe organizimi i programit të studimit është mjaftueshmërisht fleksibël për të mundësuar formimin e studentëve përgjatë programit dhe në përshtatje me punësimin me përjashtim të disa ndryshimeve në emërtimin e lëndes së "Verës" e cila mund të ndrsyhohet me "Teknologjia e prodhimit të verës". Gjithashtu lënda e "Ujit, Fruta perimeve dhe lëngjeve" mund të ndahet nag Fruta perimet të cilat mund të trajtohen në një modul më vete për shkak të rëndësisë jo vetëm në prodhimin e lëngjeve por dhe të konservave, recelrave dhe kompostove (An._3_5_1; An._3_5_3).<br><br>Në strukturën e programit të studimit përfshihen dhe praktikat mësimore dhe laboratorike në Biznese të ndryshme të Industrisë Ushqimore dhe Teknologjisë së prodhimit të Pijeve (An._3_6)<br><br>An._3_5_1_Plani Mësimor i programit të studimit TU, 2020-2021.pdf<br>An._3_5_3_Programi mësimor për TU, 2020-2021.pdf<br>An._3_6_Rregullore e Praktikës Mësimore Profesionale.pdf |
| **Kriteri 6.** Mësimit praktik dhe i elementeve të punës konkrete u është dhënë vendi dhe pesha e duhur në strukturë, vlerësim dhe rivlerësim. | Në programin e mësimor dhe planin mësimor i është dhënë një vend i vecantë praktikave mesimore dhe atyre profesionale (An._3_6; An._3_5_3; An._3_5_1). Syllabuset e praktikave paraqisin një numër të madh të bizneseve të Industrisë ushqimore si dhe të pijeve alkolike dhe jo alkolike, në të cilat studentët kanë mundësinë e praktikimit të aftësive teorike të marra në auditor dhe praktikimit të tyre në praktikë. (An._3_17).<br><br>An._3_6_Rregullore e Praktikës Mësimore Profesionale.pdf<br>An._3_5_3_Programi mësimor për TU, 2020-2021.pdf<br>An._3_5_1_Plani Mësimor i programit të studimit TU, 2020-2021.pdf<br>An._3_17_Syllabuset e lëndëve të ofruara në vitin 2020-2021.pdf |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | | **X** |

| **Standardi II.2**<br><br>**Struktura, plani mësimor dhe shpërndarja lëndore e programeve të studimit me karakter profesional, është në përputhje me objektivat formuese, rezultateve të të nxënit sipas Kuadrit Kombëtar dhe Evropian të Kualifikimeve dhe kërkesave të tregut të punës për këto programe.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi** |
| **Kriteri 1.** Emërtimi, struktura dhe shpërndarja e në vite e semestra, vlerësimi | Në këtë program studimi, një vit akademik përmban gjithsej 60 kredite, dhe dy vitet përmbajnë 120 kredite gjithsej. Kjo është në përputhje me Ligjin e arsimit të lartë nr.80/2015" |

| | |
|---|---|
| në kredite e orë mësimore është në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi. | Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë" datë 22.07. 2015, neni 21, pika 3.<br><br>An._3_5_1_Plani Mësimor i programit të studimit TU, 2020-2021.pdf<br>An._3_5_2_Kreditet sipas veprimtarive formuese për programin e studimit TU, 2020-2021.pdf<br>An._3_5_3_Programi mësimor për TU, 2020-2021.pdf<br>An._3_5_Dosja e programit të studimit TU.pdf<br>An._3_13_Të dhëna për kodifikimin e programit të studimit TU.pdf |
| **Kriteri 2.** Emërtimi, struktura dhe shpërndarja në vite e semestra, vlerësimi në kredite e orë mësimore mundëson arritjen e objektivave formues të programit të studimit, rezultateve të pritshme të të nxënit dhe punësimin e studentëve. | Në programin mësimor është përcaktuar që dy vite akademike janë të ndarë në 4 semestra. Çdo vit akademik ka 60 kredite që bëjnë gjithsej 120 kredite (An._3_5_3; An._3_5_3). Çdo vit akademik ka 1500 ore në auditor dhe jashtë tij që bëjnë gjithsej 60 kredite. Një kredit përmban 25 orë.<br><br>An._3_5_3_Programi mësimor për TU, 2020-2021.pdf<br>An._3_5_1_Plani Mësimor i programit të studimit TU, 2020-2021.pdf |
| **Kriteri 3.** Plani mësimor, natyra dhe emërtimi i moduleve/lëndëve, syllabuset e moduleve e të aktiviteteve formuese janë informuese dhe i përmbajnë të gjitha elementet e kërkuara. | Plani mësimor, natyra dhe emërtimi i moduleve/lëndëve, syllabuset e moduleve janë në përputhje me VENDIMIN Nr. 41, datë 24.1.2018 "PËR ELEMENTET E PROGRAMEVE TË STUDIMIT TË OFRUARA NGA INSTITUCIONET E ARSIMIT TË LARTË" dhe përmbajnë të gjithë elementet e kërkuara. Në të përmbahen Lëndë bazë 15%, lëndë karakterizuese 55%, lëndë ndërdisiplinore 11% nga 12 % që kërkohet në Vendimin Nr.41, dhe lëndë plotësuese 15% (An._3_5_1; An._3_17; An._3_5_3; An._3_5_2).<br><br>An._3_5_1_Plani Mësimor i programit të studimit TU, 2020-2021.pdf<br>An._3_17_Syllabuset e lëndëve të ofruara në vitin 2020-2021.pdf<br>An._3_5_3_Programi mësimor për TU, 2020-2021.pdf<br>An._3_5_2_Kreditet sipas veprimtarive formuese për programin e studimit TU, 2020-2021.pdf |
| **Kriteri 4.** Ka një raport të balancuar midis moduleve/aktiviteteve të formimit teorik përkundrejt atyre praktike (50:50). Rreth 25% e programit i dedikohet aftësimit në praktikë/punë konkrete në profesion. | Nga shqyrtimi i planit mësimor, programit mësimor dhe krediteve sipas veprimtarive formuese, raporti midis moduleve/aktiviteteve të formimit teorik përkundrejt atyre praktike është (50:50), gjithashtu 25% e programit i dedikohet aftësimit në praktikë në profesion (An._3_5_1; An._3_5_3; An._3_5_2).<br><br>An._3_5_1_Plani Mësimor i programit të studimit TU, 2020-2021.pdf<br>An._3_5_3_Programi mësimor për TU, 2020-2021.pdf |

| | |
|---|---|
| | An._3_5_2_Kreditet sipas veprimtarive formuese për programin e studimit TU, 2020-2021.pdf |
| **Kriteri 5.** Klasifikimi sipas aktiviteteve formuese dhe raportet midis formimit teorik dhe praktik mundësojnë arritjen e objektivave formues dhe orientimin e studentit drejt studimeve të mëtejshme dhe/ ose në përshtatje me pritshmëritë e kërkesat e tregut e punës. | Sipas shqyrtimit të syllabuseve për secilën lëndë dhe programit mësimor, formimi teorik dhe praktikimi në praktikë mundëson arritjen e objektivave formuese dhe e orienton studentin drejt studimeve të mëtejshme duke iu përshtatur tregut të punës (An._3_17; An._3_5_3).<br>An._3_17_Syllabuset e lëndëve të ofruara në vitin 2020-2021.pdf<br>An._3_5_3_Programi mësimor për TU, 2020-2021.pdf |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | **X** | |

| **Standardi II.3**<br>**Përmbajtja e lëndëve, moduleve dhe formave të tjera formuese të programeve të studimit me karakter profesional është në përputhje me objektivat formuese, rezultatet e të nxënit dhe kërkesat e tregut të punës për këto programe** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi** |
| **Kriteri 1.** Programi i studimit përmban të dhëna të plota mbi përmbajtjen e moduleve/lëndëve të formimit teorik e praktik dhe aktiviteteve të tjera të formimit sipas strukturës e planit të studimit. | Programi i studimit, programi mësimor, plani mësimor dhe syllabuset për secilën lëndë përmbajnë të dhëna të plota mbi përmbajtjen e moduleve/lëndëve të formimit teorik e praktik dhe aktiviteteve të tjera të formimit sipas strukturës e planit të studimit. Në syllabuset për secilën lëndë jepet informacioni i nevojshëm mbi përmbajtjen e lëndëve të formimit teorik dhe atyre praktik.<br>An._3_5_1_Plani Mësimor i programit të studimit TU, 2020-2021.pdf<br>An._3_17_Syllabuset e lëndëve të ofruara në vitin 2020-2021.pdf<br>An._3_5_3_Programi mësimor për TU, 2020-2021.pdf |
| **Kriteri 2.** Përmbajtja e programit të studimit është aktuale, i plotëson kërkesat e veçanta të profesionit dhe kërkesat për aftësitë shprehitë e kërkuara/të pritshme nga punëdhënësit. | Dy vitet akademike janë të organizuara në 4 semestra nga të cilët 3 të parët janë të përbashkët për të tre profilet "Teknologji e pijeve dhe ujit", "Teknologji e produkteve bimore", "Teknologji e produkteve shtazore".<br>Për sa i përket profilit të "Teknologjisë se pijeve dhe ujit" në semestrin e katërt zhvillohen vetëm tre lëndë "Vera", "Pijet alkolike", "Uji, Fruta perimet, dhe lëngjet" të cilat janë pak për një profil të "Teknologjisë së pijeve dhe ujit". Një përfshirje lëndëve të profilit që në semestrin e tretë do ishte më mirë për zgjerimin e njohurive në këtë profil. |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| | An._3_5_1_Plani Mësimor i programit të studimit TU, 2020-2021.pdf<br>An._3_17_Syllabuset e lëndëve të ofruara në vitin 2020-2021.pdf<br>An._3_5_3_Programi mësimor për TU, 2020-2021.pdf | | | |
| **Kriteri 3.** Përmbajtja parashikon zhvillimin e aftësive të transferueshme, e shtrirë edhe në modulet e përmbajtjen e tyre, gjatë zhvillimit të kurrikulës dhe në metodat e mësimdhënies dhe vlerësimit. | Lënda e "Verës" duhet të ishte "Teknologjia e prodhimit të verës".<br>Lënda "Uji, Fruta perimet, dhe lëngjet" duhet të ishte e ndarë "Fruta, perimet" nga "Uji dhe lëngjet jo alkolike", gjithashtu shtimi i lëndëve të profilit si "Mikrobiologjia dhe Bioteknologjia e Verës" do i shërbente më shumë shtimit të njohurive të studentëve mbi profilin e "Teknologjisë së pijeve dhe Ujit".<br>An._3_5_1_Plani Mësimor i programit të studimit TU, 2020-2021.pdf<br>An._3_17_Syllabuset e lëndëve të ofruara në vitin 2020-2021.pdf<br>An._3_5_3_Programi mësimor për TU, 2020-2021.pdf | | | |
| **Kriteri 4.** Modulet dhe aktivitetet e formimit teorik e praktik/punë konkrete mundësojnë përftimin e njohurive, aftësive dhe shkathtësive ndërkurrikulare, të menduarit kritik, zgjidhjen e problemeve në kontekste konkrete, komunikimin dhe marrëdhëniet me të tjerë, si dhe orientimin cilësor në përvojën e punës. | Lëndë si Anglisht dhe Gjermanisht zënë një vend të madh në programin e studimit. Nga 4 semestra që përmban programi, ato përfshihen në semestrin e parë dhe të dytë në Anglisht 1 dhe Anglisht 2, dhe Gjermanisht 1 dhe Gjermanisht 2, e cila ndikon më pas në ngjeshjen e lëndëve të profilit.<br>An._3_5_1_Plani Mësimor i programit të studimit TU, 2020-2021.pdf<br>An._3_17_Syllabuset e lëndëve të ofruara në vitin 2020-2021.pdf<br>An._3_5_3_Programi mësimor për TU, 2020-2021.pdf | | | |
| **Kriteri 5.** Bashkëpunimi me punëdhënësit, internship-i/përvoja praktike, tutorazhi, e vlerësimi i tyre në profesion është e mjaftueshme, e përshtatshme dhe garanton formimin praktik në përputhje me kërkesat e profesionit. | Programi mësimor, plani mësimor dhe syllabuset japin një pasqyrë të qartë të praktikave mësimore dhe profesionale që ndihmojnë studentët në praktikimin e njohurive teorike në praktikë. Në listën e bizneseve në të cilat studentët do të zhvillojnë praktikat e tyre, përfshihen një gamë e gjerë e bizneseve në Industrinë Ushqimore. Studentët në këto praktika praktikohen dhe kanë një mundësi punësimi nga njohja e tyre më drejtuesit e këtrye bizneseve.<br>An._3_6_Rregullore e Praktikës Mësimore Profesionale.pdf<br>An._3_5_1_Plani Mësimor i programit të studimit TU, 2020-2021.pdf<br>An._3_17_Syllabuset e lëndëve të ofruara në vitin 2020-2021.pdf<br>An._3_5_3_Programi mësimor për TU, 2020-2021.pdf | | | |
| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
| | | | **X** | |

| Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës II | Nuk përmbushet | Përmbushet pjesërisht | Përmbushet kryesisht | Përmbushet plotësisht |
|---|---|---|---|---|
| | | | X | |

## III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT

| **Standardi III.1**<br>**Institucioni garanton zhvillimin e mësimdhënies, mësimnxënies dhe aftësimin profesional përmes politikave e udhëzimeve të posaçme dhe mbështetet në metodat dhe praktikat më të mira të fushës** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi** |
| **Kriteri 1.** Institucioni harton udhëzues të posaçëm, ngre struktura të posaçme dhe zhvillon mekanizma të vlerësimit e të monitorimit të cilësisë së mësimdhënies dhe metodave të përdorura dhe aftësive të stafit të angazhuar, duke përfshirë aktivisht studentët në këtë proces. Rezultatet e këtyre vlerësimeve bëhen publike. | Institucioni ka ngritur NJSBC, me përbërje 5 anëtarë, ku përfshihet edhe një student. Kjo njësi ka rregulloren e vet te funksionimit. Na u pasqyrua formati i pyetësorit të vetëvlerësimit të studentëve por nuk u sqarua nga grupi i raportit te VV se ku vlerësimet bëhen publike. Në website-in e institucionit nuk rezulton të jëtë pasqyruar analiza e pyetsorëve të realizuar. Po ashtu në An._2_5_Raporti i analizës së punës vjetore (2019-2020) të KPL, nuk rezulton të jetë raportuar për vlerësimin e monitorimit të cilësisë së mësimdhënies dhe metodave të përdorura dhe aftësive të stafit të angazhuar në procesin e mësimit.<br>An._1_3_Rregullore e KUQ.pdf<br>An._1_4_Rregullore e NJSBC.pdf<br>An._3_18_Pyetësor i studentëve.pdf |
| **Kriteri 2.** Format e mësimdhënies, mësimnxënies dhe transmetimit të dijeve e njohurive janë leksionet, seminaret, laboratorët, detyra e kursit/eseja, praktikat profesionale e klinike, orët e hapura dhe çdo formë tjetër e miratuar nga institucioni e që është e përshtatshme për realizimin e programit të studimit. | Format e mësimdhënies janë të planifikuara në syllabuset e lëndëve, por ndërsa në leksionet evidentohen temat në mënyrë të detajuar nuk gjejmë në syllabuset, temat e seminareve apo laboratoreve. Na u paraqit një detyrë kursi e përgatitur nga një grup studentësh, pa u cilësuar lënda se ku zhvillohet kjo detyrë kursi.<br>An._1_12_Përdorimi i teknologjive të inovacionit dhe sistemi informatik në funksion të mësimdhënies.pdf<br>An._1_13_Udhëzim për kualifikimin e stafit akademik në KUQ.pdf<br>An._2_10_Të dhëna të plota të aktiviteteve për kualifikimin dhe kërkimin shkencor të stafit akademik të KPL në tri vitet e fundit.pdf<br>An._3_17_Syllabuset e lëndëve të ofruara në vitin 2020-2021.pdf |

| | |
|---|---|
| **Kriteri 3.** Personeli akademik përdor forma, mënyra, metoda e mundësi alternative të mësimdhënies e mësimnxënies, në përputhje me natyrën e programit të studimit në përgjithësi dhe moduleve e aktiviteteve formuese në veçanti, në përgjigje dhe të diversitetit dhe nevojave të studentëve. | Personeli akademik përdor metoda të ndryshme të mësimdhënies, në funksion të prgramit të studimit. Por në syllabuset nuk pasqyrohen tema të aftësimit praktik të studentëve, që kanë rëndësi për fromimin praktik të studentëve. KUQ ka përgatitur udhëzues për studentët për përdorimin e platformave on line si zoom, google meet, gjë që ka lehtësuar mësimdhënien dhe mësimnxënien në periudhën e pandemisë. Në listën e monografive të botuara ka 6 monografi nga të cilat 5 janë në gjuhë të huaja dhe një në gjuhën shqipe. Nuk është e qartë nëse këto monografi mund të përdoren edhe nga studentët.<br><br>An._1_12_Përdorimi i teknologjive të inovacionit dhe sistemi informatik në funksion të mësimdhënies.pdf<br>An._1_13_Udhëzim për kualifikimin e stafit akademik në KUQ.pdf<br>An._1_21_Udhëzim për përdorimin e platfomave të mësimit on-line.pdf<br>An._2_10_Të dhëna të plota të aktiviteteve për kualifikimin dhe kërkimin shkencor të stafit akademik të KPL në tri vitet e fundit.pdf |
| **Kriteri 4.** Personeli akademik i angazhuar në mësimdhënie është kompetent në shpjegimin e njohurive e koncepteve dhe përdor metoda të ndryshme të mësimdhënies, përfshirë ato interaktive e gjithëpërfshirëse, sipas tematikave dhe profilit. | Personeli akademik i angazhuar në Teknologji në 3 profilet e tij është i kufizuar në numër. Numri i lëndëve që mbulojnë 3 nga pedagogët e brendshëm të profilit teknologjik luhatet nga 6 deri në 8 lëndë. Referuar Udhëzimit nr 29, dt 10.09.2018, pedagogu duhet të mbulojë deri 3 lendë simestarle, ose 3 lëndë vjetore apo 2 lëndë vjetore dhe simestrale. Jashtë këtyre lëndëve përfshihet kontributi i tyre në praktikën profesionale në bizneset përkatëse. Një nga pedagogët e jashtëm mbulon 4 lëndë teknologjike L. Lici mbulon 4 lëndë me një total 120 orë në auditor .Sasia e orëve në auditor për tre nga pedagogët e brendshëm arrin në:<br><br>370 orë (A Sinani), 408 orë (A Xhaja), 447 (Blerta Turani). Përtej këtyre orëve është edhe angazhimi për të ndjekur praktikën profesionale. Kjo ngarkesë na duket e papranueshme për pedagogët e brendshëm.<br><br>An._3_15_Të dhëna tabelore për personelin akademik në programin TU (2020-2021).pdf<br>An._3_16_CV e stafit akademik të programit TU_2020-2021.pdf<br>8.5. Pedagoget, lendet, ngarkesa e stafit.pdf (dok shtesë) |
| **Kriteri 5.** Institucioni duhet të mbështesë stafin përmes njohjes me shembujt e praktikave të mira, të nxisë dhe të inkurajojë personelin akademik për përmirësimin e mëtejshëm të cilësisë së mësimdhënies. | KLP ka një raport të mirë të stafit të kualifikuar me stafin e ri, por gjithsesi gjykojmë që numri i pedagogëve është shumë i kufizuar, mbasi ata janë të angazhuar potencialisht me një numër të madh lëndësh. Në një situatë të tillë është e vështirë që pedagogët e rinj të kenë hapësirë për t'u kualifikuar.<br><br>An._1_3_Rregullore e KUQ.pdf |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| | An._2_10_Të dhëna të plota të aktiviteteve për kualifikimin dhe kërkimin shkencor të stafit akademik të KPL në tri vitet e fundit.pdf<br>An._3_15_Të dhëna tabelore për personelin akademik në programin TU (2020-2021).pdf | | | |
| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
| | | | **X** | |

| **Standardi III.2**<br>**Njësitë përgjegjëse garantojnë zhvillimin e mësimdhënies, mësimnxënies dhe aftësimin profesional, duke vënë në dispozicion të gjithë infrastrukturën fizike, didaktike e logjistike të nevojshme për realizimin me sukses të aktivitetit mësimor e shkencor** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi** |
| **Kriteri 1.** Procesi mësimor teorik e praktik, realizohet në hapësira të mjaftueshme dhe cilësore, funksionale dhe të pajisura me logjistikën e nevojshme për realizimin me cilësi të procesit mësimor. | Në raport paraqiten syllabuset sipas modelit të VKM por nuk paraqiten temat e praktikave dhe laboratorëve në lëndë të ndryshme. Sipërfaqja e llogaritur është 7, 8 m2/student por nëse përfshihen edhe 154 $m^2$ për bare dhe fast food. Për stafin mjediset janë të mjaftushme. Në vizitën që bënë ekspertët e vlerësimit të jashtëm, vizituan mjediset e mësimit të cilat ishin brenda standarteve, por në asnjë rast nuk gjetëm studentë në auditorë duke zhvilluar mësim. Mendojmë se ky standart në këtë institucion përmbushet mirë.<br>An._1_14_2_Infrastruktura mësimore e KUQ.pdf |
| **Kriteri 2.** Personeli akademik dhe studentët shfrytëzojnë sisteme të ndryshme informatike, infrastrukturë të konsoliduar IT të nevojshme për realizimin e procesin mësimor, si dhe sistemet e komunikimit të brendshëm për akses në dokumentacionin elektronik dhe hapësirë vetjake të dedikuar. | Në dispozicion të studentëve ka salla interneti me sipërfaqe 63 m2. Sistemi i komunikimit të brendshëm për akses në dokumentacionin elektronik mungon, mbasi studentët nuk komunikojmë përmes një rrjeti elektronik për të marrë informacion për avancimin e tyre akademik, por komunikimi kryhet përmes Ëhats App.<br>An._1_14_2_Infrastruktura mësimore e KUQ.pdf<br>An._1_21_Udhëzim për përdorimin e platfomave të mësimit on-line.pdf |
| **Kriteri 3.** Literatura bazë dhe ndihmëse e vënë në dispozicion të studentëve në gjuhën e programit të studimit (fizike dhe elektronike) garanton marrjen e dijeve dhe njohurive të nevojshme të parashikuara në programin e studimit. | Në dokumentacionin e paraqitur evidentohet që në biblotekën e studentëve ka të depozituara të gjitha tekstet mësimore për lëndët që përmban kurrikula e TU. Tekstet janë botime bashkëkohore që i takojnë viteve nga 2009-2019, të autorëve që janë pjesë e stafit por edhe të pedagogëve të UBT dhe UT. |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| | On line studentëve ju ofrohen leksionet nga pedagogët e lëndëve.<br>An._1_14_2_Infrastruktura mësimore e KUQ.pdf<br>An._3_20_Lista e teksteve në bibliotekë në funksion të programit TU.pdf | | | |
| **Kriteri 4.** Në funksion të mësimdhënies dhe mësimnxënies, personeli akademik dhe studentët aksesojnë libraritë on-line të fushave të ngjashme ose të përafërta me programin e studimit. | Në funksion të mësimdhënies dhe mësimnxënies, personeli dhe studentët raportohet, se kanë akses në libraritë on line disa pedagogë, ndërsa studentët ende nuk e kanë këtë mundësi. U vihen në dispozicion CD me literaturë të fushës.<br>An._1_12_Përdorimi i teknologjive të inovacionit dhe sistemi informatik në funksion të mësimdhënies.pdf<br>An._1_21_Udhëzim për përdorimin e platfomave të mësimit on-line.pdf | | | |
| **Kriteri 5.** Infrastruktura laboratorike e nevojshme për realizimin e laboratorëve, detyrave të kursit, diplomave dhe studimeve specifike shfrytëzohet në mënyrë të vazhdueshme nga studentët. | Në dispozicion të kryerjes së laboratorëve, mbështetur në dokumentacionin e paraqitur rezulton se ka vetëm një laborator: Lab Kimi dhe teknologji Ushqimore, prej 63 m2. Është e pamundur që vetëm me një laborator të mbulohen lënda e kimisë dhe modulet karakterizuese. Laboratori kishte paisje jo të mjaftushme për të garantuar aftësimin praktik brenda mjediseve të KLP në tre profilet e programit të TU.<br>An._1_14_2_Infrastruktura mësimore e KUQ.pdf<br>An._3_17_Syllabuset e lëndëve të ofruara në vitin 2020-2021.pdf | | | |
| **Kriteri 6.** Në funksion të mësimdhënies, personeli akademik përdor platforma on-line (elearning) dhe mbështet e nxit personelin akademik e studentët për përdorimin e tyre. | KUQ ka në dispozicion platformën on line e-learning. Për këtë ky institucion ka përgatitur një dokument mbi përdorimin e teknologjive te inovacionit dhe sistemit informatik. Është përgatitur edhe një udhëzues për përdorimin e tij.<br>An._1_12_Përdorimi i teknologjive të inovacionit dhe sistemi informatik në funksion të mësimdhënies.pdf<br>An._1_21_Udhëzim për përdorimin e platfomave të mësimit on-line.pdf | | | |
| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
| | | | **X** | |

| Standardi III.3<br><br>**Institucioni ngre struktura të posaçme në nivel institucional, të cilat garantojnë cilësinë e mësimdhënies dhe mësimnxënies në programet e studimit dhe rritjen e vetëdijes për përmirësimin e tyre** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi** |
| **Kriteri 1**. Institucioni organizon struktura/njësi në nivel institucional që ndjekin, vlerësojnë dhe monitorojnë procesin e mësimdhënies dhe koordinojnë dhe bashkërendojnë me njësitë kryesore/bazë aktivitetet në kuadër të përmirësimit të cilësisë së saj. | Në KUQ është ngritur Njësia e Sigurimit të brendshëm të Cilësisë, ku fokusi i veprimtarisë së kësaj njësie është: Evidentimi dhe ndjekja e problemeve të lidhura me cilësinë e mësimdhënies; Sigurimi i bazës së të dhënave për cilësinë e mësimdhënies; Vlerësimi periodik i reultateve të veprimtarive mësimore; Vlerësimi i ecurisë së studentëve; Organizimi dhe ndjekja e zhvillimit të pyetësorit Studentor; Orientimi dhe udhëheqja metodike për vlerësimin e brendshëm në departament dhe Vlerësimi i performancës akademike.<br>Njësia e Sigurimit të brendshëm të Cilësisë përgatit një raport pranë Rektoratit si model i vlerësimit të brendëshëm.<br>(An._1_1; An._1_3; An._1_4; An._2_3).<br>An._1_4_Rregullore e NJSBC.pdf<br>An._1_1_Statuti i KUQ.pdf<br>An._1_3_Rregullore e KUQ.pdf<br>An._2_3_Rregullore Kolegjit Profesional të Lartë1.pdf |
| **Kriteri 2**. Njësia kryesore/bazë është përgjegjëse për procesin e mësimdhënies, cilësinë e saj dhe rritjen e vetëdijes te personeli akademik dhe studentët për cilësinë në programet e studimit që ofron. | KLP dhe Departamenti bashkë me stafin akademik përgjigjen direkt për cilësinë e procesit mësimor. Me anë të kontrolleve dhe dikutimeve të vazhdueshme nxisin sigurimin e cilësisë në mësimdhënie. Nga shqyrtimet e pyetsoreve te studenteve evidentohen problemet ne mesimdhenie dhe behet zgjidhja e tyre me ane te diskutimeve ndermjet Njesise baze dhe pedagogeve perkates. Gjithashtu zhvillohen trajnime te shumta ne mesimdhenie nga profesore te vendit dhe te huaj. Kualifikimet e vazhdueshme te stafit kane ndihmuar ne rritjen e cilesise ne mesimdhenie.<br>(An._3_12; An._1_3; An._2_3; An._2_10).<br>An._3_12_Analizë vjetore e Departamentit TU.pdf<br>An._1_3_Rregullore e KUQ.pdf<br>An._2_3_Rregullore Kolegjit Profesional të Lartë1.pdf<br>An._2_10_Të dhëna të plota të aktiviteteve për kualifikimin dhe kërkimin shkencor të stafit akademik të KPL në tri vitet e fundit.pdf |
| **Kriteri 3.** Personeli akademik dhe personeli ndihmësakademik janë përgjegjës për zbatimin e programeve të studimeve dhe angazhohen për përmirësimin e mësimdhënies dhe implementimin e | Nga shqyrtimi i CV të Personelit akademik shihet që stafi akademik ka kualifikimin e duhur për zbatimin e programeve të studimeve. Gjithashtu ato angazhohen për përmirësimin e mësimdhënies dhe implementimin e metodave të reja, në përputhje me natyrën dhe specifikën e programeve |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| metodave të reja, në përputhje me natyrën dhe specifikën e programeve profesionale. | profesionale, duke marrë pjesë në trajnime të ndryshme kërkimore shkencore.<br><br>Gjithashtu stafi ndihmës akademik ndihmon në zhvillimin e praktikave mësimore të studentëve pranë laboratorëve të Departamentit.<br><br>(An._3_15; An._3_16)<br><br>An._3_15_Të dhëna tabelore për personelin akademik në programin TU (2020-2021).pdf<br><br>An._3_16_CV e stafit akademik të programit TU_2020-2021.pdf | | | |
| **Kriteri 4.** Strukturat dhe njësitë përgjegjëse mbështesin eksperimentimin dhe zhvillimin e metodave të reja inovative të mësimdhënies përmes trajnimeve të vazhdueshme të personelit akademik për përmirësimin e aftësive të mësimdhënies dhe implementimit e tyre. | Personeli akademik dhe ndihmës akademik bëjnë përpjekje të vazhdueshme për kualifikim, në procesin e mësimdhënies edhe të kërkimit shkencor, duke marrë pjesë në Konferenca Kombëtare dhe ndërkombëtare të cilat mbështeten financiarisht nga Kolegji Universitar Qirjazi.<br><br>Stafi akademik ka marre pjese ne shume Konferenca dhe Workshope ne Akadimine e Shkencave te Shqiperise apo dhe ne Universitetit Albanian University dhe shume Universitete Nderkombetare. Ne Kolegjin Universitar Qiriazi jane zhvilluar trajnime te shumta kualifikuese te stafit akademik nga profesore Brenda vendit dhe jashte sic eshte Dr. Sandy Shugar i Kolegjit "Valencia", ne Florida.<br><br>(An._1_13; An._2_10).<br><br>An._1_13_Udhëzim për kualifikimin e stafit akademik në KUQ.pdf<br><br>An._2_10_Të dhëna të plota të aktiviteteve për kualifikimin dhe kërkimin shkencor të stafit akademik të KPL në tri vitet e fundit.pdf | | | |
| **Kriteri 5.** Personeli akademik dhe personeli ndihmësakademik testojnë metoda të reja në mësimdhënie, analizojnë efektet e pritshmëritë dhe raportojnë në mënyrë periodike për rezultatet në strukturat dhe njësitë përgjegjëse. | Personeli akademik dhe personeli ndihmësakademik i Kolegjit të lartë professional "Qirizi" testojnë metoda të reja në mësimdhënie, sic është futja e Teknologjisë së Informacionit në mësimdhënie, kombinimi i trajnimeve teorike me ato praktike duke raportuar në mënyrë periodike për rezultatet në njësinë bazë.<br><br>(An._1_12; An._2_3; An._3_3)<br><br>An._2_3_Rregullore Kolegjit Profesional të Lartë1.pdf<br><br>An._1_12_Përdorimi i teknologjive të inovacionit dhe sistemi informatik në funksion të mësimdhënies.pdf<br><br>An._3_3_Rregullore e Departamentit TUT.pdf | | | |
| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| | | | | X |

| Standardi III.4<br>Institucioni harton rregullore dhe procedura të posaçme për vlerësimin e njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe garanton vlerësim të drejtë dhe transparent, bazuar në meritën për çdo student. | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi** |
| **Kriteri 1.** Kriteret dhe mënyra e testimit e vlerësimit të njohurive dijeve dhe aftësive profesionale përcaktohen në rregullore të posaçme, të cilat bëhen publike. Institucioni mban dhe ruan dokumentacionin e vlerësimeve, ankimimet dhe rishqyrtimet e vlerësimit, sipas afateve e procedurave në rregulloret përkatëse. | Në rregulloren e Departamentit, Kolegjit Universitar dhe Kolegjit Profesional Qiriazi si dhe në Syllabuset për secilën lëndë jepen qartë Kriteret dhe mënyra e testimit e vlerësimit të njohurive dijeve dhe aftësive profesionale, duke filluar nga rregullorja për pregatitjen e tezës së provimit, vlerësimi për frekuentim (50% për pjesëmarrjen në leksione, 80% për pjesëmarrje në seminare dhe 100% për pjesëmarrje në punë laboratorike) (An._3_3; An._1_3; An._2_3;).<br>An._3_3_Rregullore e Departamentit TUT.pdf<br>An._1_3_Rregullore e KUQ.pdf<br>An._2_3_Rregullore Kolegjit Profesional të Lartë1.pdf |
| **Kriteri 2.** Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore realizohet në forma dhe mënyra të ndryshme, duke i dhënë mundësi studentit të demonstrojë njohuritë dhe kompetencat e fituara. | Testimi e vlerësimi i njohurive paraqitet qarte në rregulloren e departamentit dhe përfshin vlerësimin e studentëve për seminaret, ushtrimet, punët laboratorike, projekt kurset, detyrat me shkrim, detyra kursi përvec provimit përfundimtar që zhvillohet në sezon. (An._3_3)<br>An._3_3_Rregullore e Departamentit TUT.pdf |
| **Kriteri 3.** Në fillim të çdo lënde/moduli, studentët informohen me metodologjinë e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore të parashikuara në syllabuset e lëndëve/ moduleve nga titullari i lëndës /modulit. | Në syllabuset për secilën lëndë jepen qartë mënyra e vlerësimit për secilën lëndë, në të cilën kontrolli i ndërmjetën zë 20%, detyra e kursit 10%, frekuentimi 10%, dhe provimi përfundimtar 60% (An._3_17)<br>An._3_17_Syllabuset e lëndëve të ofruara në vitin 2020-2021.pdf |
| **Kriteri 4.** Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet gjatë gjithë vitit akademik, duke venë në zbatim sisteme elektronike të testimit dhe vlerësimit, të cilat garantojnë anonimatin, eliminojnë forma të ndryshme abuzimi dhe rrisin transparencën. | Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet gjatë gjithë vitit akademik, vlerësimin e studentëve për seminaret, ushtrimet, punët laboratorike, projekt kurset, detyrat me shkrim, detyra kursi por sisteme elektronike të testimit nuk paraqiten në rregulloret e Departamentit, Kolegjit Universitar apo dhe Kolegjit Profesional Qiriazi. Sekretimi i provimit ruan anonimatin, gjithashtu studenti ka të drejtë ankimimi. (An._3_3; An._1_3; An._2_3;).<br>An._3_3_Rregullore e Departamentit TUT.pdf |

| | |
|---|---|
| | An._1_3_Rregullore e KUQ.pdf<br>An._2_3_Rregullore Kolegjit Profesional të Lartë1.pdf |
| **Kriteri 5.** Vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet nga komisione provimi, shoqërohet me komente e këshilla mbi procesin e të nxënit për të ndihmuar studentin të përmirësohet në të ardhmen. | Në rregulloren e Departamentit, Kolegjit Universitar dhe Kolegjit Profesional Qiriazi jepen qartë ngritja e komisioneve të provimit për vlerësimin e njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale, dhe gjithashtu shoqërohet me komente e këshilla mbi procesin e të nxënit për të ndihmuar studentin të përmirësohet në të ardhmen. (An._3_3; An._1_3; An._2_3;).<br>An._3_3_Rregullore e Departamentit TUT.pdf<br>An._1_3_Rregullore e KUQ.pdf<br>An._2_3_Rregullore Kolegjit Profesional të Lartë1.pdf |
| **Kriteri 6.** Rezultatet e kontrollit të dijeve dhe aftësive profesionale bazohen në meritë dhe jepen në kohë sipas përcaktimeve në rregulloret përkatëse, duke garantuar njëkohësisht të drejtat e studentëve, për t'u njohur me vlerësimin, kërkesën për rishikim të vlerësimit në përputhje me këto rregullore. | Rezultatet e kontrollit të dijeve dhe aftësive profesionale bazohen në meritë dhe jepen në kohë sipas përcaktimeve në rregulloret përkatëse si atë të Departamentit, Kolegjit Universitar dhe Kolegjit Profesional Qiriazi dhe studenti ka të drejtë ankimimi në kohë (An._3_3; An._1_3; An._2_3;).<br>An._3_3_Rregullore e Departamentit TUT.pdf<br>An._1_3_Rregullore e KUQ.pdf<br>An._2_3_Rregullore Kolegjit Profesional të Lartë1.pdf |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | **X** | |

| **Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës III** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | **X** | |

## IV. BURIMET PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT DHE MBËSHTETJA E STUDENTËVE

| **Standardi IV.1** |
|---|

| **Institucioni i arsimit të lartë ka përgjegjësinë primare për përzgjedhjen dhe cilësinë e personelit që mbulon programin e studimit dhe mbështetjen për kryerjen e detyrave në mënyrë efiçente dhe efektive nga ana e tyre** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi** |
| **Kriteri 1.** Institucioni harton dhe zbaton procedura dhe kritere të përgjithshme dhe specifike të shpallura, që garantojnë përzgjedhjen e personelit me nivelin e duhur të kualifikimit dhe në përputhje me natyrën, strukturën, modulet dhe përmbajtjen e programit të studimit, në përputhje me bazën ligjore në fuqi dhe aktet e brendshme rregullatore të tij. | Kolegji Universitar "Qiriazi" harton procedura e kritere të posaçme e specifike për rekrutimin e personelit, të cilat janë pjesë e akteve rregullatore dhe i bën ato publike të përcaktuara mirë në statutin e Kolegjit Universitar. (An._1_1)<br>Kriteret shpallen publikisht dhe përzgjedhja bëhet me konkurs, në përputhje me bazën ligjore në fuqi dhe aktet e brendshme rregullatore të Institucionit. Kriteret përcaktohen nga Departamenti në bazë të vendit të punës që kërkohet dhe miratohet nga Dekani dhe i përcillen Rektorit nga zyra e burimeve njerëzore. Kriteret janë A. Eleminuese, B. Preferuese dhe vlerësuese, C.Plotesuese, D.Intervistë me gojë.<br><br>(An._1_6)<br>An._1_1_Statuti i KUQ.pdf<br>An._1_6_Rregullore e zyrës së burimeve njerzore prot_arkivit.pdf |
| **Kriteri 2.** Institucioni mbledh, ruan dhe përditëson çdo vit akademik të dhënat e personelit të angazhuar në programin e studimit. Këto të dhëna përfshijnë anëtarët e personelit akademik të përfshirë në program, personin përgjegjës për organizimin e programit të studimit, angazhimin e çdo anëtari në çdo semestër dhe vit akademik, përfshirë tutorët apo vëzhguesit e praktikës në institucionet partnere, si dhe atë të personelit ndihmësmësimor-shkencor dhe administrativ të angazhuar. | Kolegji Universitar "Qiriazi" me anë të Drejtorisë së burimeve njerëzore mbledh, ruan dhe përditëson çdo vit akademik, të dhënat e personelit të angazhuar në programin e studimit (An._1_6).<br>Departamenti i "Teknologjisë ushqimore dhe Turizmit", për programet dhe lëndët që menaxhojnë dhe Drejtoria e Burimeve Njerëzore në nivel institucional, mbajnë të dhëna të plota dhe të hollesishme në lidhje me anëtarët e personelit akademik të përfshirë në program dhe të personit përgjegjës për organizimin e programit të studimit, angazhimin e çdo anëtari në çdo semestër dhe vit akademik, si dhe atë të personelit ndihmësmësimor-shkencor dhe administrative përfshirë tutorët apo vëzhguesit e praktikës në institucionet partnere (An._1_6_1; An._3_16).<br>An._1_6_Rregullore e zyrës së burimeve njerzore prot_arkivit.pdf<br>An._1_6_1_Formati i Dosjes personale të stafit.pdf<br>An._3_16_CV e stafit akademik të programit TU_2020-2021.pdf |
| **Kriteri 3.** Institucioni dëshmon një angazhim optimal të burimeve njerëzore për përmbushjen e objektivave të programeve të studimit me karakter profesional dhe për krijimin e mjedisit dhe mundësive të përshtatshme dhe të barabarta për | Institucioni angazhohet për krijimin e mjedisit dhe mundësive të përshtatshme dhe të barabarta për kryerjen e detyrave të personelit në mënyrë profesionale, me anë të krijimit të kushteve të laboratorëvë përkatës mësimorë dhe kërkimorë si dhe zhvillimit të praktikave profesionale në Biznese të ndryshme të Industrisë ushqimore, për të cilat ekziston një numër i madh i këtyre Bizneseve dhe marrëveshjeve që kanë me këto Biznese si dhe Institucione të tjera të Arsimit të lartë) (An._3_11; An._1_14_2) |

| | |
|---|---|
| kryerjen e detyrave të personelit në mënyrë profesionale. | Nga shqyrtimi i jeteshkrimeve të stafit, tregohet që personeli i cili mbulon programin e studimit është një staf me kualifikimin përkatës për secilin modul. (An._3_16; An._3_15).<br>Nga vizita që u bë në këtë Institucion ambientet fizike ishin të mjaftueshme për kryerjen e proçeseve mësimore. Rregulli dhe pastërtia mbizotëronte kudo.<br><br>An._3_11_Raporti i fundit i përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit pë programin e studimit TU.pdf<br><br>An._1_14_2_Infrastruktura mësimore e KUQ.pdf<br><br>An._3_16_CV e stafit akademik të programit TU_2020-2021.pdf<br><br>An._3_15_Të dhëna tabelore për personelin akademik në programin TU (2020-2021).pdf |
| **Kriteri 4.** Institucioni angazhohet për kualifikimin e vazhdueshëm dhe zhvillimin e mëtejshëm profesional të personelit që mbulon dhe administron programin e studimit, përmes organizimit të programeve specifike për metodat inovative të mësimdhënies e përdorimit të teknologjive të reja, si dhe mbështetjen për kualifikimin e mëtejshëm profesional të personelit akademik e të personelit mësimor-shkencor. | Institucioni ndjek nje plan trajnimi sipas prioriteteve të tij dhe inkurajon trajnimin dhe promovimin e personelit akademik në Universitete brënda dhe jashë vendit, sic është Universiteti La Sapienza në Romë apo Albanian University. Ai mbështet zhvillimin e konferencave shkencore nga njesitë bazë, pjesëmarrjen e pedagogëve ne konferenca dhe aktivitete të ndryshme shkencore jashtë vendit me anë të financimit të tyre nga Bordi i Administrimit të vetë Kolegjit Universitar (An._1_13; An._1_16; An._1_12).<br>Trajnimet zhvillohen në bazë të programit të përcaktuar nga konsorciumi i projektit për lëvizjet e stafit akademik. Gjithashtu në nivel Departamenti është zhvilluar dhe trajnim i pedagogëve mbi mesimdhënien nga pedagogë të ftuar nga Universitete nga jashtë vendit (An._2_10).<br><br>An._1_13_Udhëzim për kualifikimin e stafit akademik në KUQ.pdf<br><br>An._2_10_Të dhëna të plota të aktiviteteve për kualifikimin dhe kërkimin shkencor të stafit akademik të KPL në tri vitet e fundit.pdf<br><br>An._1_16_Vendim Bordi_pagesat për konferenca e paisjen e biliotekës.pdf<br><br>An._1_12_Përdorimi i teknologjive të inovacionit dhe sistemi informatik në funksion të mësimdhënies.pdf |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | | **X** |

| **Standardi IV.2**<br><br>**Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion mjedise mësimore dhe infrastrukturën e përshtatshme për realizimin e procesit mësimdhënës të programeve të studimit dhe për formimin praktik, të përshtatshëm sipas natyrës dhe fushës së programit të studimit me karakter profesional** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi** |
| **Kriteri 1.** Institucioni siguron mjediset e mjaftueshme dhe të përshtatshme mësimore për zhvillimin e veprimtarisë mësimdhënëse teorike, në varësi të numrit të studentëve, grupeve mësimore, në përputhje me natyrën specifike të programit të studimit dhe moduleve përkatëse. | Në përputhje me Vendimin Nr. 418, datë 10.5.2017 "Për standardet, kriteret dhe procedurat për hapjen, riorganizimin, ndarjen, bashkimin ose mbylljen e institucioneve të arsimit të lartë dhe të degëve të tyre", rezulton se Institucioni Kolegji Universitar "Qiriazi" siguron mjediset e mjaftueshme dhe të përshtatshme mësimore për zhvillimin e veprimtarisë mësimdhënëse teorike, në varësi të numrit të studentëve, grupeve mësimore, në përputhje me natyrën specifike të programit të studimit dhe moduleve përkatëse. Secilit student i përket 7.8$m^2$ sipërfaqe nga 2.5 $m^2$ që përcaktohet me Vendimin Nr. 418 (An._1_14; An._1_14_2).<br><br>An._1_14_Raport Vlerësimi (Relacion i ambienteve mësimore të Kolegjit).pdf<br><br>An._1_14_2_Infrastruktura mësimore e KUQ.pdf |
| **Kriteri 2.** Mjediset mësimore, si: klasat, laboratorët, studiot e mjediset e tjera janë të pajisura me pajisje elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, që garantojnë realizimin e procesit mësimor teorik e praktik, përmes përdorimit të metodologjive e teknologjive bashkëkohore të mësimdhënies-mësimnxënies. | Kolegji Profesional Qiriazi garanton realizimin e procesit mësimor teorik e praktik, përmes përdorimit të metodologjive e teknologjive bashkëkohore të mësimdhënies-mësimnxënies. Departamenti shfrytëzon brenda Institucionit salla të cilat janë te pajisura me kompjuter, videoprojektor, ekrane të medha, dërrasa të bardha, etj. Ndërkohë, klasat janë të pajisura me të gjitha lehtësirat e nevojshme per të lehtësuar si punën në grupe të mëdha, ashtu dhe atë në grupe të vogla, si dhe internet në cdo kohë. Kjo u vëzhgua dhe nga vizita që u bë në Institucion (An._1_14; An._1_12)<br><br>An._1_14_Raport Vlerësimi (Relacion i ambienteve mësimore të Kolegjit).pdf<br><br>An._1_12_Përdorimi i teknologjive të inovacionit dhe sistemi informatik në funksion të mësimdhënies.pdf |
| **Kriteri 3.** Laboratorët, studiot, atelietë apo mjediset e tjera, sipas fushës specifike të programit profesional, përmbajnë aparaturat dhe mjetet e nevojshme e të përshtatshme për plotësimin e kërkesave të moduleve, aftësimit teorik e praktik dhe të objektivave formues të programit të studimit në tërësi. | Departamenti i Teknologjisë Ushqimore dhe Turizmit është i pajisur me laboratorë mësimorë që përmbajnë aparaturat dhe mjetet e nevojshme e të përshtatshme për plotësimin e kërkesave të moduleve, aftësimit teorik e praktik.<br>Nga vizita në Institucion u vërejt që Departamenti ka laboratorë mesimorë me pajisjet e duhura shkencore si në laboratorin e Teknologjisë Ushqimore me pajisje për analiza fiziko-kimike të produkteve ushqimore (An._1_14_2; An._3_4_1).<br><br>An._1_14_2_Infrastruktura mësimore e KUQ.pdf<br><br>An._3_4_1_Rregullore e Laboratorit në TU.pdf |

| | |
|---|---|
| **Kriteri 4.** Institucioni siguron së paku një laborator të teknologjisë së informacionit, të pajisur me programe profesionale sipas natyrës së programit/eve të studimit që ofron. | Departamenti i Teknologjisë Ushqimore dhe Turizmit është i pajisur me një laborator informatike dhe internet me një kapacitet prej 23 vetash. Ndërsa si Kolegj kanë dy salla informatike. Kjo u vëzhgua dhe nga vizita e kryer në Institucion (An._1_14_2).<br><br>An._1_14_2_Infrastruktura mësimore e KUQ.pdf |
| **Kriteri 5.** Institucioni garanton, me kapacitetet që zotëron dhe/ose në bashkëpunim me institucione dhe subjekte të tjera, që mjediset janë të mjaftueshme, të përshtatshme dhe të posaçme për zhvillimin e praktikave profesionale, internship-it dhe veprimtarive të tjera praktike thelbësore për programet me karakter profesional. | Studentëve të këtij Departamenti i ofrohen ambjente për zhvillimin e parktikave laboratorike por ofron laboratore të sigurisë ushqimore, njësi prodhimi të produkteve ushqimore, apo fabrika të përpunimit të produkteve ushqimore për zhvillimin e praktikave profesionale dhe veprimtarive të tjera praktike, me anë të marrveshjeve të shumta që kanë me biznese të Industrisë Ushqimore. Te gjithe keto facilitate ndihmojnë shumë zhvillimin e kompetencave praktike të studenteve (An._3_10; An._3_11).<br><br>An._3_10_Tabelë përmbledhëse me institucionet bashkëpunuese për programin e studimit TU dhe për praktikën profesionale.pdf<br><br>An._3_11_Raporti i fundit i përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit pë programin e studimit TU.pdf |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | | **X** |

| **Standardi IV.3**<br><br>**Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve mjedise mbështetëse e të posaçme të mësimnxënies, bibliotekën e literaturën dhe mbështetjen financiare të nevojshme për mbarëvajtjen e programit të studimit dhe realizimin cilësor të tij** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi** |
| **Kriteri 1.** Institucioni vë në dispozicion të studentëve bibliotekën mësimore, duke garantuar mundësinë e shfrytëzimit në mënyrë të barabartë nga studentët e programit të studimit dhe krijon kushte për akses të barabartë e pa pagesë dhe të jetë e pajisur me programe kompjuterike dhe pajisje të tjera teknike që mundësojnë shfrytëzimin pa kufizime nga ana e të gjithë studentëve. | Kolegji Universitar 'Qiriazi" vë në dispozicion të studentëve bibliotekën mësimore, duke garantuar mundësinë e shfrytëzimit në mënyrë të barabartë nga studentët e programit të studimit, si të literaturave bazë, atyre ndihmëse, revistave të ndryshmë shkencore në gjuhën shqipe dhë të huaj. Biblioteka ëahtë e pajisur me 1358 libra në gjuhën shqipe dhe të huaj dhe është e hapur nga ora 8.00 deri në 16.00 në dispoziciontë studentëve dhe e pajisur me kompjutera dhe me internet gjithashtu (An._1_11; An._1_12; An._1_14_2).<br><br>An._1_11_Rregullore e brendshme e bibliotekës.pdf<br><br>An._1_12_Përdorimi i teknologjive të inovacionit dhe sistemi informatik në funksion të mësimdhënies.pdf |

| | |
|---|---|
| | An._1_14_2_Infrastruktura mësimore e KUQ.pdf |
| **Kriteri 2.** Biblioteka duhet të jetë e pajisur me literaturë mësimore bazë, ndihmëse, e mjaftueshme në gjuhën shqipe dhe të huaja, të mjaftueshme dhe të përshtatshme për mbulimin e të gjitha moduleve e veprimtarive mësimore sipas natyrës e specifikës së programit të studimit. | Biblioteka është e pajisur me literaturë fizike, si: tekste mësimore bazë, literaturë ndihmëse, e mjaftueshme në gjuhë shqipe dhe të huaja, libra apo revista shkencore të nevojshme, të mjaftueshme dhe e përshtatshme për mbulimin e të gjitha moduleve e veprimtarive mësimore sipas natyrës e specifikës së programit të studimit (An._1_11; An._1_12; An._1_16; An._3_20).<br><br>An._1_11_Rregullore e brendshme e bibliotekës.pdf<br><br>An._1_12_Përdorimi i teknologjive të inovacionit dhe sistemi informatik në funksion të mësimdhënies.pdf<br><br>An._1_16_Vendim Bordi_pagesat për konferenca e paisjen e biliotekës.pdf<br><br>An._3_20_Lista e teksteve në bibliotekë në funksion të programit TU.pdf |
| **Kriteri 3.** Institucioni duhet të krijojë kushte për akses të barabartë e pa pagesë për studentët në bibliotekat on-line të fushës së programit të studimit dhe duhet të hartojë e zbatojë një plan të detajuar për shtimin e zërave të bibliotekës, përditësimin e fondit ekzistues në mbështetje të programit. | Biblioteka është e mjaftueshme me numrin e madh të librave që ka por pasurimi i mëtejshëm i saj gjithnjë e më shumë me literaturë bashkëkohore do ndihmonte më shumë pedagogët dhe studentët për tu njohur me të inovacionet e fundit. Bibliotekës i është dhuruar nga Akademia e shkencave një fond prej 410 librash, në bazë të marrëveshjes institucionale që kanë këto dy Institucione. Institucioni po punon për pasjen e një Biblioteke online. Nga Bordi i Administrimit është marrë vendim për financimin e librave të rinj në bibliotekë dhe përditësimin e fondit ekzistues (An._1_12; An._1_16).<br><br>An._1_12_Përdorimi i teknologjive të inovacionit dhe sistemi informatik në funksion të mësimdhënies.pdf<br><br>An._1_16_Vendim Bordi_pagesat për konferenca e paisjen e biliotekës.pdf |
| **Kriteri 4.** Institucioni, përmes bashkëpunimit me aktorë të jashtëm, të angazhuar në realizimin e programit mësimor, duhet t'u lehtësojnë dhe garantojë studentëve mbështetjen dhe përdorimin e burimeve e logjistikës së nevojshme të institucioneve partnere, në varësi të natyrës së angazhimit të tyre në procesin formues teorik, praktik dhe profesional të studentëve. | Kolegji Universitar "Qirjazi" përmes bashkëpunimit me Biznese të Industrisë Ushqimore dhe Institucioneve të tjera të Arsimit të lartë, angazhohet në realizimin e programit mësimor, dhe u garanton studentëve mbështetjen dhe përdorimin e burimeve e logjistikës së nevojshme të institucioneve partnere me anë të zhvillimit të praktikave profesionale në Biznese të ndryshme të Industrisë ushqimore, për të cilat ekziston një numër i madh i këtyre Bizneseve dhe marrëveshjeve që kanë me këto Biznese si dhe Institucione të tjera të Arsimit të lartë (An._3_10; An._3_11).<br><br>An._3_10_Tabelë përmbledhëse me institucionet bashkëpunuese për programin e studimit TU dhe për praktikën profesionale.pdf<br><br>An._3_11_Raporti i fundit i përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit pë programin e studimit TU.pdf |

| | |
|---|---|
| **Kriteri 5.** Institucioni parashikon koston financiare të programit të studimit profesional, mbështetjen financiare të nevojshme për mbarëvajtjen e programit të studimit për të paktën një cikël të plotë studimi dhe raportin financiar të përvitshëm dhe në mbyllje të çdo cikli të plotë studimi. | Shpërndarja e burimeve bëhet sipas një plani financiar. Me hapjen e programit të Teknologjisë Ushqimore është strukturuar një plan për mbarëvajtjen e këtij programi studimi si dhe një raport financiar të përvitshëm në mbyllje të çdo cikli të plotë studimi. Bordi i financimit përcakton rregullat e shpërndarjes së burimeve të finacimit dhe mbikqyr shpërndarjen e fondeve për realizmin e programit (An._1_14_1; An. 3_19).<br>An._1_14_1_Plani buxhetor 2018-2025 për menaxhimin e institucionit.pdf<br>An._3_19_Të dhëna nga plani i financimit të programit të studimit TU.pdf |
| **Kriteri 6.** Financimi i një programi studimi profesional duhet të sigurojë e të garantojë mbulimin e të gjitha burimeve dhe veprimtarive të qëndrueshme dhe operative, të lidhura e që janë në funksion të realizimit të programit të studimit, duke garantuar njëkohësisht qëndrueshmërinë financiare përgjatë kohës së zhvillimit të programit të studimit e në vijim. | Burimet financiare të Institucionit janë të ardhurat e vetë Institucionit dhe nuk ka përfituar të ardhura nga palë të treta. Alokimi i të ardhuarve bëhet në bazë të nevojave të Departamentit duke ndjekur një politikë transparente dhe gjithëpërfshirëse. Janë ngritur laboratorët e Teknologjisë Ushqimore, të Informatikës e Hoteleri Turizmit më fond të miratuar nga Bordi i Administrimit. Veprimtaria kërkimore shkencore, dhe pjesëmarrja në Konferenca mbështetet financiarisht nga fonde nga Bordi i Administrimit (An._1_14_1; An._14_2; An._1_16).<br>An._1_14_1_Plani buxhetor 2018-2025 për menaxhimin e institucionit.pdf<br>An._1_14_2_Infrastruktura mësimore e KUQ.pdf<br>An._1_16_Vendim Bordi_pagesat për konferenca e paisjen e biliotekës.pdf |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | **X** | |

| **Standardi IV.4**<br>**Institucioni i arsimit të lartë harton, ndjek, zbaton politika e procedura institucionale dhe i jep formacion të plotë e të hollësishëm studentëve mbi programin e studimit me karakter profesional, pranimin, përzgjedhjen, përparimin akademik, vlerësimin e dijeve dhe diplomimin në programin e studimit** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi** |
| **Kriteri 1.** Institucioni harton, zbaton dhe bën publike politika, procedura e kritere të qarta e të kuptueshme për pranimit e studentëve, përparimin e tyre përgjatë kursit të studimit, të vlerësimit të dijeve dhe të diplomimit, | Kolegji Universitar "Qiriazi" informon studentët me anë të fletëpalosjeve të përgatitura nga Universiteti për pranimin e tyre. Ndërsa për orientimin, këshillimin e studentëve shërben Zyra e Marrëdhënieve me jashtë, Pranimit dhe Këshillimit të Studentëve. Studentët kanë në cdo kohë internet (An._1_14_1; An. 3_19). |

| | |
|---|---|
| të cilat garantojnë barazinë dhe të drejta të njëjta për të gjithë kandidatët për studentë dhe studentët, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet e veta rregullatore. | Mënyra e vlerësimit të studentëve dhe informimit të tyre nuk bëhet më anë të një sistemi online sic është ai ESSE për shembull në Universitetin Bujqësor Tiranë apo në Universitete të tjera publike.<br>An._1_9_Rregullore e zyrës mardh_jasht_pranim_keshillit për karriere.pdf<br>An._1_17_Fletpalosje Kolegjit Universitar "Qiriazi".pdf |
| **Kriteri 2.** Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kritere të përgjithshme dhe/ose të veçanta për pranimin dhe përzgjedhjen e kandidatëve në programet e studimit me karakter profesional dhe udhëzon publikun dhe të interesuarit në lidhje me to. | Në rregulloren e Kolegjit Universitar "Qiriazi", si edhe në rregulloren e studimeve të Departamentit të Teknologjisë, parashikohen dhe përshkruhen në mënyrë të qartë, procedurat e pranimit të studentëve në bazë të udhëzimeve të MASR. Kolegji Universitar "Qiriazi" dhe Departamentit të Teknologjisë Ushqimore dhe Turizmit, çdo vit përgatit paketën e informacionit orientues për aplikantët/maturantët të interesuar për të aplikuar në programin e studimit. Në Ëebsite-in e Kolegjit Universitar "Qiriazi" dhe Departamentit të Teknologjisë Ushqimore dhe Turizmit, janë të publikuara programet e studimit, kuotat si edhe kriteret e pranimit (An._1_3; An. 2_9).<br>An._1_3_Rregullore e KUQ.pdf<br>An._2_9_kriteret e pranimit studenteve në KPL.pdf |
| **Kriteri 3.** Institucioni vë në dispozicion informacion të plotë dhe të hollësishëm në lidhje me kriteret e procedurat e përparimit akademik të studentëve, zhvillimin e veprimtarive praktike e profesionale të programit dhe institucionet bashkëpunuese në këto veprimtari, vlerësimit të dijeve e aftësive të studentëve dhe diplomimit. | Në Ëebsite-in e Kolegjit Universitar "Qiriazi" (ëëë.qiriazi.edu.al) janë të publikuara programet e studimit, kuotat si edhe kritereve të pranimit.<br>Në fakultet organizohen edhe ditë të hapura me maturantët për të infomuar rreth programeve të studimit, këshillimit të karrierës dhe mundësitë për punësim. Institucioni ndjek dhe praktika të informimit të maturantëve nëpërmjet veprimtarive në shkolla të mesme të qytetit. Institucioni informon studentët dhe me numrin e madh të bizneseve të Industrisë ushqimore me të cilët ka marrëveshje bashkëpunimi për kryerjen e praktikave profesionale (An._1_3; An. 3_10; An._1_17; An. 2_9).<br>An._1_3_Rregullore e KUQ.pdf<br>An._1_17_Fletpalosje Kolegjit Universitar "Qiriazi".pdf<br>An._2_9_kriteret e pranimit studenteve në KPL.pdf<br>An._3_10_Tabelë përmbledhëse me institucionet bashkëpunuese për programin e studimit TU dhe për praktikën profesionale.pdf |
| **Kriteri 4.** Studentët informohen në mënyrë të hollësishme për strukturën, organizimin, kohëzgjatjen e programit të studimeve, mundësitë e punësimit, si dhe mbështetjen institucionale për orientimin drejt dhe në tregun e punës. | Studentët informohen në mënyrë të hollësishme për strukturën, organizimin, kohëzgjatjen e programit të studimeve, mundësitë e punësimit me anë të fletëpalosjeve dhe faqet së ëebsite-it (ëëë.qiriazi.edu.al). Institucioni vë në dispozicion bursa për studentët me probleme ekonomike dhe për studentët me rezultate të larta.<br>Institucioni informon studentët dhe me numrin e madh të bizneseve të Industrisë ushqimore me të cilët ka marrëveshje bashkëpunimi për kryerjen e praktikave profesionale si dhe |

| | |
|---|---|
| | mundësinë e punësimit pas mbarimit të studimeve (An._1_3; An. 3_10; An._1_17; An._1_15).<br>An._1_3_Rregullore e KUQ.pdf<br>An._1_17_Fletpalosje Kolegjit Universitar "Qiriazi".pdf<br>An._3_10_Tabelë përmbledhëse me institucionet bashkëpunuese për programin e studimit TU dhe për praktikën profesionale.pdf<br>An._1_15_Vendimi i Bordit të Administrimit per tarifa dhe bursa.pdf |
| **Kriteri 5.** Institucioni vë në dispozicion të studentëve informacion dhe udhëzues të posaçëm për modulet, lëndët, përmbajtjen, veprimtaritë formuese dhe informacion të gjerë e të përditësuar mbi zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të tij. | Çdo fillim viti pedagogët informojnë studentët mbi kurrikulat, sylllabuset dhe planet mësimore dhe mënyrat e vlerësimit gjatë vitit dhe provimin përfundimtar. Studentët njihen me infrastruktruën mësimore si laboratorët mësimore, të informatikës, sallat e studimit dhe bibliotekës. Studentët njihen me antë të faqes zyrtare dhe me fletëpalosjet e pregatitura nga vetë Institucioni (An._1_3; An._1_17).<br>An._1_3_Rregullore e KUQ.pdf<br>An._1_17_Fletpalosje Kolegjit Universitar "Qiriazi".pdf |
| **Kriteri 6.** Informacioni në lidhje me programin e studimit mundësohet përmes sistemit të menaxhimit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jetë lehtësisht i arritshëm nga studentët edhe në distancë. | Me anë të sistemit të menaxhimit të brendshëm të informacionit dhe faqes zyrtare të internetit, Kolegji Universitar "Qiriazi" dhe Departamenti i Teknologjisë Ushqimore dhe Turizmit informon studentët ne lidhje me programin e studimit dhe detajet e cdo programi studimi. Me anë të këtij sistemi, fletëpalosjeve dhe udhëzimit të platformave online, u vihet në ndihmë dhe studentëve në distancë (An._1_12; An. 1_21; An._1_17).<br>An._1_21_Udhëzim për përdorimin e platfomave të mësimit on-line.pdf<br>An._1_12_Përdorimi i teknologjive të inovacionit dhe sistemi informatik në funksion të mësimdhënies.pdf<br>An._1_17_Fletpalosje Kolegjit Universitar "Qiriazi".pdf |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | | **X** |

| **Standardi IV.5**<br>**Institucioni i arsimit të lartë disponon një sistem të brendshëm të menaxhimit institucional dhe e vë atë në dispozicion të administrimit, informimit dhe monitorimit të aktivitetit akademik, financiar e administrativ për programin e studimit me karakter profesional** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi** |

| | |
|---|---|
| **Kriteri 1.** Institucioni disponon sistem të menaxhimit nëpërmjet të cilit administron të gjithë informacionin që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre nga regjistrimi deri në diplomimin e daljen në tregun e punës. | Institucioni me anë të sekretarisë mësimore disponon sistem të menaxhimit nëpërmjet të cilit administron të gjithë informacionin që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre nga regjistrimi deri në diplomimin e daljen në tregun e punës.<br><br>Institucioni disponon dhe mban statistika vjetore për numrin e studentëve e të diplomuarve për çdo program studimi. Sekretaria mësimore pranë njësisë bazë, realizon procedurën e regjistrimit sipas Rregullores së Sekretarisë mësimore (An. 1_8; An._1_10; An._1_12).<br><br>An._1_8_Rregullore për ruajtjen dhe arkivimin e dokumentacionit.pdf<br><br>An._1_10_Rregullore e Sekretarisë Mësimore.pdf<br><br>An._1_12_Përdorimi i teknologjive të inovacionit dhe sistemi informatik në funksion të mësimdhënies.pdf |
| **Kriteri 2.** Sistemi i brendshëm i menaxhimit administron informacionin, dokumentacionin dhe aktivitetin e personelit akademik, personelit ndihmësakademik, personelit administrativ dhe të partnerëve të angazhuar në realizimin e programit. | Zyra e Burimeve njerëzore, Protokollit dhe Arkivit pranë Institucionit KUQ ka të gjithë informacionin, dokumentacionin mbi aktivitetin e personelit akademik, personelit ndihmës akademik, personelit administrativ dhe partnerëve të angazhuar në realizimin e programit, si dhe aktmarrëveshjet me Institucione të tjera të arsimit të lartë brënda dhe jashtë vendit. (An. 1_6; An._1_6_1; An._3_10).<br><br>An._1_6_Rregullore e zyrës së burimeve njerzore prot_arkivit.pdf<br><br>An._1_6_1_Formati i Dosjes personale të stafit.pdf<br><br>An._3_10_Tabelë përmbledhëse me institucionet bashkëpunuese për programin e studimit TU dhe për praktikën profesionale.pdf |
| **Kriteri 3.** Sistemi i menaxhimit siguron akses të dedikuar në informacione e dokumente për të gjithë personelin dhe studentët e programit të studimit. | GVJ zhvilloi takim në Sekretarinë mësimore dhe pa afër Rregjistrin Themeltar të studentëve, Rregjistrin e notave dhe atë të diplomimit.<br>Zyra e sekretarisë mësimore ruan informacion për ecurinë e studentit nga njëri vit akademik në tjetrin deri në diplomimin e tyre. Zyra e sekretarisë mësimore bën regjistrimin e studentëve dhe mbajtjen e bazës së të dhënave mbi studentët dhe rezultatet e tyre, në formë shkresore dhe elektronike; Plotëson dhe dorëzon diplomat; Lëshon vërtetim mbi ciklin e studimeve dhe e shoqëron atë me listën e notave.<br><br>Ndërsa të dhënat mbi personelit mbahen nga Zyra e Burimeve njerëzore, Protokollit dhe Arkivit pranë Institucionit (An. 1_6; An._1_10).<br><br>An._1_6_Rregullore e zyrës së burimeve njerzore prot_arkivit.pdf<br><br>An._1_10_Rregullore e Sekretarisë Mësimore.pdf |

| | |
|---|---|
| **Kriteri 4.** Sistemi i menaxhimit ka të integruar platforma dhe module që mundësojnë forma të komunikimit interaktiv dhe shkëmbimit të informacionit ndërmjet personelit dhe studentëve. | Shkëmbimi i informacionit ndërmjet personelit dhe studentëve është bërë me anë të integrimit të platformave dhe moduleve që mundësojnë forma të komunikimit interaktiv. Postat elektronike të secilit pedadog kanë shërbyer për komunikimin e studentëve me pedagogët e lëndëve përkatëse. Gjatë periudhes së zhvillimit të mësimit online Institucioni ka integruar platform si Google meeting, Zoom, Google Clasroom, Google Hangout për zhvillimin e mësimit (An. 1_12).<br><br>An._1_12_Përdorimi i teknologjive të inovacionit dhe sistemi informatik në funksion të mësimdhënies.pdf |
| **Kriteri 5.** Sistemi i menaxhimit garanton monitorim në kohë reale të aktivitetit akademik e administrativ dhe mundëson raportime individuale dhe të dhëna në kohë reale për organet drejtuese dhe titullarët. | Me anë të përditësimit të të dhënave në faqen zyrtare www.qiriazi.edu.al, sistemi i menaxhimit garanton monitorim në kohë reale të aktivitetit akademik e administrativ dhe mundëson raportime individuale dhe të dhëna në kohë reale për organet drejtuese dhe titullarët. Kjo faqe përditësohet nga njësia kryesore, bazë dhe pedagogu përgjegjës për të (An. 1_12).<br><br>An._1_12_Përdorimi i teknologjive të inovacionit dhe sistemi informatik në funksion të mësimdhënies.pdf |
| **Kriteri 6.** Informacionet që lidhen me programet e studimit, personelin akademik dhe aktivitetet e ndryshme publikohen në faqen e internetit në të paktën dy gjuhë ku të paktën njëra prej tyre është gjuha shqipe. | Në faqen zyrtare të Institucionit jepen informacione që lidhen me programet e studimit, personelin akademik dhe aktivitetet e ndryshme, vendime të senatit, tarifat e studimit, misioni, historiku dhe publikohen në dy gjuhë ku të paktën njëra prej tyre është gjuha shqipe dhe tjetra është në gjuhën angleze.<br><br>www.qiriazi.edu.al |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | **X** | |

| **Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës IV** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | | **X** |

## V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE

| **Standardi V.1** |
|---|

| Institucioni i arsimit të lartë harton, ndjek dhe zbaton politika dhe procedura për pranimin, përzgjedhjen, përparimin e studentëve, transferimin, njohjen, vlerësimin e dijeve dhe diplomimin, në programin e studimit dhe i vë në dispozicion të studentëve të programit të studimit | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi** |
| **Kriteri 1.** Institucioni harton dhe zbaton politika, procedura dhe kritere të pranimit, përparimit, të transferimit, njohjes së studimeve të mëparshme ose të pjesshme, të vlerësimit të dijeve dhe të diplomimit të studentëve, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet e veta rregullatore dhe që janë lehtësisht të kuptueshme dhe të aksesueshme nga publiku. | Institucioni ka një kuadër ligjor të lavdërueshëm sa i takon procedurave dhe kritereve të pranimit, transferimit dhe njohjes së studimeve, gjë që sanksionohet në të dy rregulloret e KUQ dhe KLP. Në nenin 24, 25 dhe 26 të Rregullores së KLP struktura e programit të studimit ka një ndarje jo cituar korrektesisht të programit në pjesën e përgjithshme dhe profesionale. Programi i ofruar është vetëm një por ai ka në përbërje module të karakterit të përgjithsëhm dhe profesionale. Në nenin 30 flitet për planin mësimor, mënyrën e hartimit të tij dhe elementët në përbërje të planit mësimor, por në fakt paraqitja e planit mësimor të ofruar për TU nuk ka këtë përmbajtje sepse pikat d, e dhe f nuk janë pjesë e planit.<br><br>An._1_3_Rregullore e KUQ.pdf<br>An._1_10_Rregullore e Sekretarisë Mësimore.pdf<br>An._1_18_Programi i punës për rregjistrimet_2018-2019&2019_2020 dhe komisionet e veçanta.pdf<br>An._2_3_Rregullore Kolegjit Profesional të Lartë1.pdf<br>An._2_9_kriteret e pranimit studenteve në KPL.pdf |
| **Kriteri 2.** Politikat dhe procedurat nga hyrja në dalje dhe orientimin drejt tregut të punës, garantojnë barazinë dhe të drejta të njëjta për të gjithë kandidatët për studentë dhe studentët e programit të studimit. | Rregulloret në fuqi si dhe dokumentacioni i paraqitur garantojnë barazinë e studentëve dhe atyre që pranohen ne KLP. Ka dokumentacion të përsëritur sepse në rregulloren KLP, në atë të Departamentit dhe në rregulloren e diplomimit ka shumë trajtesa të përsëritura. Procedurat e pranimit pasqyrohen edhe në fletëpalosjen si dhe në website e Kolegjit Qiriazi. Në Rregulloren e Zyrës së marëdhënieve me jashtë pranim dhe keshillimin e karierës, në mënyrë të detajuar studentëve ju jepet informacion për mënyrën se si duhet të operojnë për tu orientuar në karierën e tyre të punësimit.<br><br>An._1_3_Rregullore e KUQ.pdf<br>An._1_9_Rregullore e zyrës mardh_jasht_pranim_kshillit për karriere.pdf<br>An._1_10_Rregullore e Sekretarisë Mësimore.pdf<br>An._1_17_Fletpalosje Kolegjit Universitar "Qiriazi".pdf<br>An._2_3_Rregullore Kolegjit Profesional të Lartë1.pdf<br>An._3_3_Rregullore e Departamentit TUT.pdf<br>An._3_7_Rregullore e Diplomimit.pdf |
| **Kriteri 3.** Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kritere të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve dhe, përpara fillimit të çdo viti akademik, udhëzon publikun dhe të interesuarit në lidhje me | Informacioni për kriteret e pranimit janë të publikuara në ëeb site e instistucionit si dhe ne dokumentacionin e kritereve të pranimit. Për aplikim në të gjitha programet me karakter profesional në Kolegjin Universitar "Qiriazi" nota mesatare e studimeve të arsimit të lartë të mesëm si përllogaritje e mbështetur në Vendimin e Këshillit të Ministrave, nuk përbën kriter hyrës. |

| | |
|---|---|
| kërkesat e kriteret e përgjithshme e të veçanta të programit të studimit. | An._2_3_Rregullore Kolegjit Profesional të Lartë1.pdf<br>An._2_9_kriteret e pranimit studenteve në KPL.pdf |
| **Kriteri 4.** Institucioni vë në dispozicion informacion të plotë dhe të hollësishëm në lidhje me kriteret e procedurat e përparimit akademik të studentëve, kalimit nga një vit akademik në tjetrin, procedurat e njohjeve të kualifikimeve të mëparshme ose studimeve të pjesshme. | Rregulloret e institucionit dhe KLP japin një informacion të plotë të përparimit akademik të studentëve , mënyrën e kalimit nga një vit në tjetrin si dhe njohjen e rezultateve që studentët kanë fituar në lëndë të ngjashme apo të njëjta në institucione të tjera, kur transferohen prane KLP. Në rregulloren e KLP nuk ka informacion apo nene specifike për njohjen e studimeve të pjesshme.<br>An._1_3_Rregullore e KUQ.pdf<br>An._1_9_Rregullore e zyrës mardh_jasht_pranim_kshillit për karriere.pdf<br>An._2_3_Rregullore Kolegjit Profesional të Lartë1.pdf<br>An._3_3_Rregullore e Departamentit TUT.pdf |
| **Kriteri 5.** Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e vlerësimit të dijeve e aftësive të studentëve në programin e studimit dhe diplomimit në programin e studimit. | Rregulloret me të cilat operon ky program studimi japin informacion të plotë mbi vlerësimin e dijeve dhe aftësive si dhe diplomimin. Në Rregulloren e programit të studimit në TU, studentëve ju jepet një informacion i detajuar për ngarkesën totale në orë dhe kredite të programit në të tre profilet e tij, për formën e zhvillimit të mësimit, procedurat dhe standartet për zhvillimin e provimeve, modalitetet për shlyerjen e detyrimeve për studentët e vitit të fundit, për praktikën profesionale dhe mbrojtjen e praktikës profesionale, provimi I përgjithshëm përfundimtar dhe afatet e diplomimit.<br>An._3_4_Rregullore e Programit të Studimit TU.pdf<br>An._3_5_Dosja e programit të studimit TU.pdf<br>An._3_7_Rregullore e Diplomimit.pdf<br>An._3_17_Syllabuset e lëndëve të ofruara në vitin 2020-2021.pdf |
| **Kriteri 6.** Përpara fillimit të çdo viti akademik dhe në mënyrë periodike, institucioni publikon udhëzues të posaçëm dhe organizon takime të hapura për informimin e të interesuarve e studentëve të ardhshëm mbi programin e studimit. | Institucioni përmes ëeb cite, fletepalosjes, kritereve të pranimit të KLP, por edhe në takime të organizuara me maturantët sipas grafikut të publikuar nga MASR, informohen të interesuarit për programin e ardhshëm. KUQ për të tërhequr sa më shumë kandidatë për studentët në institucionin e vet ka organizuar kurse falas për matematike në dy vitet e fundit. KPL ka përcaktuar përmes një dokumenti edhe kriteret e pranimit në programin e studimit në të tre profilet. Prioritet në pranim i kanë dhënë kandidatëve që vijnë nga shkolla të mesme teknologji ushqimore dhe hoteleri turizëm.<br>An._1_9_Rregullore e zyrës mardh_jasht_pranim_kshillit për karriere.pdf<br>An._1_17_Fletpalosje Kolegjit Universitar "Qiriazi".pdf<br>An._2_3_Rregullore Kolegjit Profesional të Lartë1.pdf<br>An._2_9_kriteret e pranimit studenteve në KPL.pdf<br>An._3_3_Rregullore e Departamentit TUT.pdf |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| | | | | X |

| Standardi V.2<br><br>**Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve informacion të plotë e të hollësishëm për objektivat formuese, strukturën, organizimin, përmbajtjen e programit të studimit, rezultatet e pritshme të të nxënit dhe mundësitë e punësimit** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi** |
| **Kriteri 1.** Institucioni informon në mënyrë të hollësishme studentët për strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimeve dhe ve në dispozicion të tyre, informacion dhe dokumentacion/ udhëzues të posaçëm për modulet, lëndët, përmbajtjen dhe veprimtaritë formuese të programit të studimit me karakter profesional. | Institucioni zotëron rregullore e informacion për strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e studimeve. Ky informacion mund thuhet se mund të aksesohet nga studentët në disa forma: përmes ëebsite, guidave studentore, apo afishimit të rregulloreve në mjedise të aksesueshme nga studentët. Në ëebsite nuk ekzistonte ky informacion. Po ashtu nuk ka guida studentore, por ka fletëpalosje, ku ky informacion mungon.<br><br>An._1_3_Rregullore e KUQ.pdf<br>An._1_9_Rregullore e zyrës mardh_jasht_pranim_kshillit për karriere.pdf<br>An._1_10_Rregullore e Sekretarisë Mësimore.pdf<br>An._1_17_Fletpalosje Kolegjit Universitar "Qiriazi".pdf<br>An._2_3_Rregullore Kolegjit Profesional të Lartë1.pdf<br>An._3_3_Rregullore e Departamentit TUT.pdf |
| **Kriteri 2.** Institucioni informon studentët mbi praktikat profesionale në kuadër të realizmit të programit të studimit, partnerët dhe institucionet bashkëpunuese ku parashikohen të realizohen, si dhe mundësitë e punësimit e mbështetjen institucionale për orientimin drejt e në tregun e punës. | Përmes rregullores së departamentit, studentët mund të informohen për praktikën profesionale, mbasi aty ka një kapitull që i dedikohet posacërisht praktikës profesionale. Në rregullore thuhet që studentëve ju jepet një program i praktikës profesionale. Institucioni përmes marrëveshjeve me institucione publike dhe private garanton mbështetjen për praktikën profesionale.<br><br>An._1_17_Fletpalosje Kolegjit Universitar "Qiriazi".pdf<br>An._2_3_Rregullore Kolegjit Profesional të Lartë1.pdf<br>An._3_3_Rregullore e Departamentit TUT.pdf<br>An._3_10_Tabelë përmbledhëse me institucionet bashkëpunuese për programin e studimit TU dhe për praktikën profesionale.pdf |
| **Kriteri 3.** Studentëve u vihet në dispozicion informacion i gjerë dhe i përditësuar mbi zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të tij. | KLP përmes komunikimit që realizon me studentët në ditët e para të fillimit të vitit akademik i informon për organizimin e procesit mësimor, infrastukturën. Informacioni që ju shpërndahet në fillim të programit të studimit merret nga Rregullorja e departamentit TUT, ku detajohen cështje të tilla si, zgjatja e programit, kreditet, plani mësimor, auditoret ku zhvillohen leksionet dhe laboratorët, detyrimet që kanë studentët për të frekuentuar programin, provimet dhe mënyrat e zhvillimit të tyre, etj. |

| | |
|---|---|
| | An._2_3_Rregullore Kolegjit Profesional të Lartë1.pdf<br>An._3_3_Rregullore e Departamentit TUT.pdf |
| **Kriteri 4.** Informacioni në lidhje me programin e studimit mundësohet përmes sistemit të menaxhimit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jetë lehtësisht i arritshëm nga studentët edhe në distancë. | Sistemi informatik i institucionit egziston dhe funksionon për studentët e KUQ. Platforma moodle u jep mundësi studentëve të administrojnë procesin mësimor në distance. Në vizitën që bënë ekspertët, mungonte aksesi në internet.<br>An._1_12_Përdorimi i teknologjive të inovacionit dhe sistemi informatik në funksion të mësimdhënies.pdf<br>An._1_14_2_Infrastruktura mësimore e KUQ.pdf<br>An._1_21_Udhëzim për përdorimin e platfomave të mësimit on-line.pdf |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | **X** | |

| **Standardi V.3**<br>**Institucioni i arsimit të lartë mbledh, administron, përditëson dhe ruan të dhëna të hollësishme në lidhje me numrin e profilin e studentëve që ndjekin programin e studimit me karakter profesional, nga pranimi në diplomim, si dhe të dhëna të punësimit të tyre përmes një sistemi menaxhimi informatik të brendshëm** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi** |
| **Kriteri 1.** Institucioni disponon dhe mban statistika vjetore për numrin e studentëve e të diplomuarve në vitet paraardhëse në programin e studimit. | KLP mban dokumentacion për numrin e studentëve në vitet paraardhëse, gjë që sanksionet në Regulloren e sekretarisë mësimore, si dhe në Rregulloren për ruajtjen dhe arkivimin e dokumentacionit. Nga kjo rezulton se në vitin akademik 2019-2020 janë diplomuar 32 studentë dhe për vitin akademik 2020-2021 janë diplomuar 13 studentë. Mungon dokumentacioni i librit të diplomave meqë akoma nuk janë shpërndarë diplomat tek studentët që kanë kryer mbarimin e studimeve. Ky dokumentacion do të procedohet mbasi të merret vlerësimi institucional dhe programor.<br>An._1_1_2_U_MASR_Hapja e KPL dhe programeve TI&TU&HT.pdf<br>An._1_8_Rregullore për ruajtjen dhe arkivimin e dokumentacionit.pdf<br>An._1_10_Rregullore e Sekretarisë Mësimore.pdf<br>An._3_7_Rregullore e Diplomimit.pdf |
| **Kriteri 2.** Institucioni disponon dhe ruan statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar, tërheqjet nga programi, si dhe largimet para | Institucioni dokumenton numrin e studentëve të regjistruar, tërheqjet nga programi, largimet apo mospërfundimet të programit të studimit. Kjo sanksionohet në Rregulloren e secretarisë, në raportin vjetor të KLP dhe raportin vjetor të analizës së dep të TU |

| | |
|---|---|
| përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik në të cilin zhvillohet programi i studimeve. | për vitin akademik 2019-2020. Na bie në sy që tabelat që pasqyrojnë numrin e studentëve në programet profesionale, janë me shifra të ndryshme.<br>An._1_8_Rregullore për ruajtjen dhe arkivimin e dokumentacionit.pdf<br>An._1_10_Rregullore e Sekretarisë Mësimore.pdf<br>An._2_5_Raporti i analizës së punës vjetore (2019-2020) të KPL.pdf<br>An._3_12_Analizë vjetore e Departamentit TU.pdf |
| **Kriteri 3.** Institucioni disponon të dhëna për ecurinë e studentëve gjatë zhvillimit të programit të studimeve që nga pranimi deri në diplomimin e tyre, përfshirë punësimin eventual të tyre. | E vetmja zyrë ku mund të gjejmë statistika për ecurinë vjetore të studentëve është sekretaria mësimore, e cila arshivon informacionin. Për sa i përket punësimit eventual të studentëve, kjo gjë evidentohet në analizën vjetore të departamenit, ku theksohet që deri aktualisht janë punësuar vetëm tre student. Sikurse më lart, kjo statitikë e punësimit të studentëve në vitet në vazhdim duhet të menaxhohet nga zyra për marëdhënie me jashtë, pranim, këshillim dhe karierë. Në dokuemntacionin shtesë të dorëzuar tek grupi i vlerësimit të jashtëm rezulton se numri i studentëve të diplomuar arrin në 11.<br>An._1_7_Rregullore_mbrojtja të dhënave personale_KUQ.pdf<br>An._1_8_Rregullore për ruajtjen dhe arkivimin e dokumentacionit.pdf<br>An._1_10_Rregullore e Sekretarisë Mësimore.pdf<br>An._3_12_Analizë vjetore e Departamentit TU.pdf<br>3.1. Tabela mbi punesimin e studenteve te diplomuar.pdf( dok shtese) |
| **Kriteri 4.** Të dhënat statistikore të studentëve menaxhohen përmes sistemit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jenë të sigurta dhe lehtësisht të verifikueshme nga personat e autorizuar. | Institucioni deklaron që të dhënat statistikore ruhen në CD të verifikueshme nga cdokush që i kërkon ato. Kjo gjë sanksionohet në Rregulloren e Sekretarisë Mësimore.<br>An._1_10_Rregullore e Sekretarisë Mësimore.pdf<br>An._1_12_Përdorimi i teknologjive të inovacionit dhe sistemi informatik në funksion të mësimdhënies.pdf |
| **Kriteri 5.** Institucioni duhet të hartojë raporte analitike periodike mbi profilin dhe cilësinë në hyrje dhe dalje të studentëve, si dhe të shkallës së cilësisë së punësimit të tyre, duke e shoqëruar me masat e duhura në drejtim të përmirësimit të këtyre treguesve. | Institucione ka vënë në dispozicion një raport të analizës së punës mësimore dhe shkencore për vitin akademik 2018-2019, dorëzuar në MASR në dhjetor të vitit 2020. Në këtë raport ka një informacion për cilësinë e studentëve në hyrje edhe për në dalje. Mendoj se raporti mund të ishte më i detajuar me të dhëna të tilla si profili i shkollave nga vijnë kandidatët që hyjnë në KLP, preferenca në zgjedhje e degës, gjeografia e ardhjes së kontigjentëve, duke e lidhur këtë situatë edhe me profilet e bizneseve ushqimore që operojnë në zonat e tyre gjeografike të origjinës. Nuk gjemë të dokumentuara masa konkrete për përmirësuar cilësinë e punësimit tëstudentëve.<br>An._1_19_Shkresa Nr_317 dt.29.12.2020 e KUQ për MASR "Dergim raporti vjetor i KUQ 2019-2020.pdf<br>An._3_7_Rregullore e Diplomimit.pdf<br>An._3_12_Analizë vjetore e Departamentit TU.pdf |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| | | | | |
| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
| | | | | **X** |

| **Standardi V.4**<br><br>**Institucioni i arsimit të lartë përfshin dhe angazhon studentët në organet vendimmarrëse e këshilluese, në kuadër të hartimit, miratimit, rishikimit e përmirësimit të programit të studimit, metodave të mësimdhënies dhe cilësisë së burimeve e shërbimeve ndaj tyre** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi** |
| **Kriteri 1.** Institucioni parashikon përfshirjen dhe angazhimin e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në organet vendimmarrëse e këshilluese sipas akteve ligjore dhe atyre rregullatore të vetë IAL-ve. | Mbështetur në Statutin e KUQ, përkatësisht neni 9, pika 2 dhe neni 47, sanksionohet pjesmarrja e studentëve në strukturat vendimamarrëse të institucionit. Po ashtu po në statut sanksionohet pjesmarja e studentëve në struktura këshilluese, ku citohen Këshillat studentore, të cilat , krahas angazhimit për aktivitete social kulturore kanë angazhim edhe në dhënien e mendimeve për programet mësimore, hapjen e programeve të reja , etj. Nuk na u ekspozua ndonjë dokumentacion për këtë pjesmarrje dhe angazhim. Në KUQ ka edhe një student përfaqsues në NJBSC.<br><br>An._1_1_Statuti i KUQ.pdf<br>An._1_20_Veprimtari e shoqatave të studenteve në KUQ.pdf<br>An._3_18_Pyetësor i studentëve.pdf |
| **Kriteri 2.** Institucioni duhet të garantojë se përfshirja e studentëve dhe/ose e përfaqësuesve të tyre në vendimmarrje, këshillim apo vlerësimin mbi procesin akademik të jetë reale, konkrete, frutdhënëse dhe me rezultate lehtësisht të verifikueshme e të matshme. | Në dokumentacionin e plote të institucionit, e kryesisht në Statutin KUQ, sanksionohet përfshirja e studentëve. Në takimin me studentët ne u njohëm me studentin senator, i cili deklaroi pjesmarjen e tij active në mbledhje dhe në diskutime. Aktivizimi i studentit në mbledhjet e Senatit evidentohet kur Senati trajton problematika që lidhen direkt me interesat dhe kërkesat e studentëve.<br><br>An._1_1_Statuti i KUQ.pdf |
| **Kriteri 3.** Në hartimin dhe përmirësimin e programeve të studimit, institucioni duhet të mbajë parasysh ngarkesën akademike të studentëve në programin e studimit dhe parashikimin e procedurave joburokratike të përparimit të studentëve përgjatë programit, përfshirë njohjen e studimeve të plota apo të pjesshme të mëparshme. | KLP ka respektuar ngarkesën akademike të përparimit të studentëve në programin e studimeve gjatë dy viteve të studimit. Kjo gjë verifikohet përmes planit mësimor dhe programit mësimor të programit TU në të tre profiet e saj. Meqënëse ky program studimi është tepër i ri, nuk ka pasur raste të transferimeve, por gjithsesi në Rregulloren e Kolegjit Profesional në nenin 36 citohet njohja e krediteve të kandidatëve që kanë kryer studime të pjesshme apo të mëparshme.<br><br>An._3_3_Rregullore e Departamentit TUT.pdf<br>An._3_5_1_Plani Mësimor i programit të studimit TU, 2020-2021.pdf<br>An._3_5_3_Programi mësimor për TU, 2020-2021.pdf |

| | |
|---|---|
| | An._3_12_Analizë vjetore e Departamentit TU.pdf<br>An._3_18_Pyetësor i studentëve.pdf |
| **Kriteri 4.** Institucioni garanton përfshirjen e studentëve në procesin e hartimit, rishikimit dhe përmirësimit të programeve të studimit mbi baza të rregullta dhe të reflektojë sugjerimet e kontributin e tyre në to. | KUQ ka parashikuar pjesmarrjen e studentëve në procesin e e hartimit dhe përmirësimit të programeve të studimit, sanksionuar sikurse më sipër në Statutin e institucionit (pjesëmarrja në senat dhe NJSBC. Po kështu institucioni bazuar në rregulloren e KLP, ka parashikuar zhvillimin e pyetsorëve ku merret informacion mbi procesin mësimor, problematikën apo vlerësimin e tij. Në dokumentacion na u paraqit forma e pyëtsorit por jo rezultati i opinioneve të studentëve për procesin mësimor.<br>An._1_1_Statuti i KUQ.pdf<br>An._3_18_Pyetësor i studentëve.pdf |
| **Kriteri 5.** Studentëve u mundësohet të japin mendim mbi barazinë dhe ndershmërinë e kryerjes së procesit të vlerësimit e kontrollit të dijeve, përfshirë mundësinë e ankimimit të rezultatit, rishikimit dhe reflektimit nga ana e institucionit/ njësisë/pedagogut përgjegjës. | Studentët kanë të drejtë të apelojnë rezultatin e provimit përmes ankimimit në Departament. Kjo gjë sanksionohet në Rregulloren e Dep TUT, neni 33 dhe rregulloren e KLP neni 56 dhe 59. Kjo gjë sanksionohet edhe në pyetsorët e plotësuar nga studentët.<br>An._2_3_Rregullore Kolegjit Profesional të Lartë1.pdf<br>An._3_2_Plani strategjik i zhvillimit të programit TU.pdf<br>An._3_18_Pyetësor i studentëve.pdf |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | | **X** |

| **Standardi V.5**<br>**Institucioni ka procedura e njësi të posaçme për pritjen, orientimin, këshillimin e studentëve, menaxhimin e ankimimeve e problematikave, të cilat operojnë në mënyrë permanente e janë lehtësisht të arritshme e të përdorshme nga studentët** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi** |
| **Kriteri 1.** Institucioni ka procedura e njësi të posaçme në shërbim të informimit e shërbimit të studentëve, në përputhje me parashikimet ligjore dhe aktet rregullatore të IAL-ve. | Institucioni ka një rregullore të zyrës së maredhenieve me jashtë, pranim dhe këshillim për kariere, neni 3, ku studenti orientohet kryesisht për karierën e ardhshme dhe pak për avancimin në jetën akademike. Më shumë mbështetje dhe informimi i studentëve kryhet përmes rolit të sekretarisë mësimore dhe tutoreve.<br>An._1_1_Statuti i KUQ.pdf<br>An._1_9_Rregullore e zyrës mardh_jasht_pranim_kshillit për karriere.pdf<br>An._1_10_Rregullore e Sekretarisë Mësimore.pdf |

| | |
|---|---|
| | An._3_21_Vendim për emërimin e Tutorit të programit të studimit, detyrat e tij.pdf |
| **Kriteri 2.** Në institucion është ngritur dhe funksionon një sistem i posaçëm për mirëpritjen, informimin, këshillimin, ndjekjen e përparimit të studentëve dhe ndihmesën e tyre për çështje që kanë të bëjnë me procesin mësimor dhe programin e studimit. | Institucioni mbështet studentët në mbritjen në institucion, informimin, këshillimin, ndjekjen e jetës akademike, tutorëve të kursit të studimit, si dhe informacionit të shpërndarë. Tutorët e kursit të studimit luajnë një rol të kujdesshëm në këtë drejtim.Për veprimtarinë e tyre madje ka edhe një vendim të posatshëm të drejtorit të KLP. Kjo veprimtari u konfirmua edhe nga studentët në intervistën që patëm me ta.<br><br>An._1_9_Rregullore e zyrës mardh_jasht_pranim_kshillit për karriere.pdf<br>An._3_21_Vendim për emërimin e Tutorit të programit të studimit, detyrat e tij.pdf |
| **Kriteri 3.** Përmes zyrës/njësisë për këshillimin e karrierës, institucioni mirëpret studentët në mënyrë të vazhduar dhe periodike, duke ofruar informacion dhe orientim të posaçëm lidhur me plotësimin e detyrimeve të procesit mësimor, zgjedhjen dhe orientimin për praktikën profesionale në institucione të tjera dhe orientimin në tregun e punës. | Sikurse më sipër cituam, institucioni duket se këtë veprimtari e ka të organizuar korektësisht përmes dokumentacionit të përmendur në kriterin 1 dhe 2.<br><br>An._1_9_Rregullore e zyrës mardh_jasht_pranim_kshillit për karriere.pdf<br>An._3_10_Tabelë përmbledhëse me institucionet bashkëpunuese për programin e studimit TU dhe për praktikën profesionale.pdf |
| **Kriteri 4.** Zyra/njësia e karrierës ndjek studentët pas diplomimit, mbledh, përpunon e mban të dhëna mbi shkallën dhe cilësinë e punësimit të studentëve të programit të studimit, ua vë ato në dispozicion studentëve dhe organeve e autoriteteve drejtuese përkatëse dhe merr masa për përmirësimin e shkallës dhe cilësisë së punësimit të tyre. | Ky informacion duket se është ende inekzistent, nga fakti se studentët e parë janë diplomuar para një viti akademik 2019-2020. Mbetet të evidentohet në vitet në vijim se si zyra e karirës do ta ushtrojë këtë rol, si ajo do ta mbledhi, përpunojë dhe finalizojë këtë informacion.<br><br>An._1_9_Rregullore e zyrës mardh_jasht_pranim_kshillit për karriere.pdf<br><br>An._1_10_Rregullore e Sekretarisë Mësimore.pdf |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | **X** | |

| **Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës V** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | | **X** |

**Përfundime të Vlerësimit të programit të studimit me karakter professional "Teknologji ushqimore", në profilet "Teknologji e pijeve dhe ujit", "Teknologji e produkteve bimore" dhe "Teknologji e produkteve shtazore" të Institucionit të Arsimit të Lartë Kolegjit Universitar "Qiriazi"**

**Pikat e forta dhe afirmime**

1. Stafi akademik që mbulon dispiplinat karakterizuese me karakter professional studimi ka një kualifikim të pëlqyeshëm, një me gradë Prof dhe dy me gradë Dr.
2. Infrastruktura mësimore përgjithësisht e përshtatshme, duke marrë në konsideratë sallat e leksioneve dhe të seminareve.
3. Komunikimi staf -student i admirueshëm.
4. Programi i studimit është atraktiv për mjedisin shqiptar.
5. Institucioni ka marrëveshje bashkëpunimi me Universitetin Bujqësor të Tiranës dhe biznese private të fushës së ushqimit, ku mundësohet zhvillimi i praktikave profesionale (tek këto të fundit).
6. Një pjesë e studentëve janë gjithashtu punonjës në fabrika të përpunimit të ushqimit.
7. Institucioni ka një kuadër institucional të pëlqyeshëm gjë që reflektohet në rregulloret që ata kanë përgatitur si për funksionimin akademik dhe atë administrative.

**Pika të dobta**

1. Pjesa më e madhe e kandidatëve që regjistrohen në këtë program studimi vijnë me një mesatare të ulët nga shkollat e mesme.
2. Një pjesë e madhe e studentëve nuk vijnë nga shkolla të mesme profesionale, por nga gjimnazet.
3. Stafi akademik që mbulon lëndët me karakter professional është i pamjaftueshëm, gjë që i vendos ata në një presion të zhvillimit njëkohësht të shumë lëndëve brenda semestrit apo në të tërë vitin akademik.
4. Stafi akademik nuk është i përfshirë në projekte ndërkombëtare apo kombëtare, gjë që i pengon ata të avancohen në karierën shkencore për të fituar grada dhe tituj shkencorë.
5. Tekstet mësimore që ju ofrohen studentëve kanë një nivel të lartë akademik, gjë që vështirëson mësimnxënien e tyre.
6. Vendondodhja e institucionit është larg qëndrës së Tiranës, gjë që pengon ardhjen e studentëve në një kohë të shpejtë në KLP.
7. Nuk ka një rrjet të komunkimit për avancimin e karrierës së studentëve. Informacioni nga studentët merret përmes komunikimit me Whats App.

8. Mënyra e vlerësimit të studentëve dhe informimit të tyre nuk bëhet më anë të një sistemi elektronik online sic është psh ai ESSE në Universitete të tjera publike.

**Rekomandime**

1. Të rritet numri i pedagogëve të brendshëm me qëllim që të ulet ngarkesa vjetore akademike dhe pedagogëve tu krijohen hapsira kohore për të kualifkuar veten.
2. Të punohet shumë më tepër nga stafi i zyrës së marrëdhënieve me jashtë me qëllim që të thithen kandidatë nga rrethet ku bizneset e ushqimit janë më të përqendruuara.
3. Të instalohet një rrjet komunkimi on line për studentët.
4. Të rriten hapsirat për laboratorët e lëndëve teknologjike, mbasi një laborator është tërësisht i pamjafteshëm për të përmbushur aftësimin praktik të studentëve në tre profilet që ka programi.
5. Përsa i përket profilit të "Teknologjisë se pijeve dhe ujit" në semestrin e katërt zhvillohen vetëm tre lëndë "Vera", "Pijet alkolike", "Uji, Fruta perimet, dhe lëngjet" . Me këtë informacion të limituar teorik dhe praktik është e vështirë të përgatitet një specialist për profilin e "Teknologjisë së pijeve dhe ujit". Gjykojmë që një zgjidhje mund të ishte përfshirja e lëndëve të profilit që në semestrin e tretë me qëllim që të zgjerohen njohuritë në këtë profil.
6. Lëndët si Anglisht dhe Gjermanisht zënë një peshë të madhe në programin e studimit. Nga 4 semestra që përmban programi, ato përfshihen në semestrin e parë dhe të dytë (Anglisht 1 & Anglisht 2, dhe Gjermanisht 1 & Gjermanisht 2), gjë që rëndon kurrikulën me këto lëndë dhe pamundëson përfshirjen me një peshë më të madhe të lëndëve karakterizuese.
7. Lënda me emertimin "Vera" duhet të ishte "Teknologjia e prodhimit të verës".
8. Lënda "Uji, Fruta perimet, dhe lëngjet" duhet të trajtohet e ndarë "Fruta, perimet" nga "Uji dhe lëngjet jo alkolike". Gjithashtu shtimi i lëndëve të profilit si "Mikrobiologjia dhe Bioteknologjia e Verës" do i shërbente më shumë shtimit të njohurive të studentëve mbi profilin e "Teknologjisë së pijeve dhe Ujit".
9. Nga vizita në Institucion u vërejt që Departamenti ka laboratorë mesimorë përgjithësisht të paisur me instrumentat më bazikë në pjesën e Teknologjisë Ushqimore (kryerjen e analizave fiziko-kimike të produkteve ushqimore), por e theksojmë si domosdoshmëri ndarjen në ambjente të vecanta të laboratorit të mikrobiologjisë nga ai i teknologjisë.

## Conclusions of the study program Evaluation of professional character in the "Food Technology", in the profiles "Technology of Beverages and Water", "Technology of Plant Products" and "Technology of Animal Products" of the Institution of Higher Education University College "Qiriazi"

**Strengths and affirmations**

1. The academic staff that covers the characteristic disciplines with a professional study character has a satisfactory qualification, one with a Prof Degree and two with a Dr. Degree.
2. Generally appropriate teaching infrastructure, taking into account lecture and seminar rooms.
3. Admirable staff-student communication.
4. The study program is attractive for the Albanian environment.
5. The institution has cooperation agreements with the Agricultural University of Tirana and private businesses in the field of food, which enables the development of professional practices (to the latter).
6. Some students are also employees in food processing factories.
7. The institution has a pleasing institutional framework which is reflected in the regulations they have prepared for both academic and administrative functioning.

**Weak points**

1. Most of the candidates enrolled in this study program come with a low average from high schools.
2. A large part of the students do not come from vocational high schools, but from gymnasiums.
3. The academic staff that covers the courses of professional character is insufficient, which puts them under a pressure of simultaneous development of many courses within the semester or throughout the academic year.
4. Academic staff is not involved in international or national projects, which prevents them from advancing in scientific careers to earn scientific degrees and titles.
5. Textbooks offered to students have a high academic level, which makes it difficult for them to learn.
6. The location of the institution is far from the center of Tirana, which prevents the arrival of students in a fast time in KLP.
7. There is no communication network for student career advancement. Information from students is obtained through communication with What's App.
8. The way of evaluating students and informing them is not done through an electronic online system such as the ESSE in other public Universities.

**Recommendation**

1. To increase the number of internal lecturers in order to reduce the annual academic workload and create time spaces for lecturers to qualify themselves.
2. Work much harder than the staff of the foreign relations office in order to attract candidates from the districts where the food businesses are more concentrated.
3. Install an online communication network for students.
4. Increase the space for laboratories of technological subjects, as one laboratory is completely insufficient to meet the practical training of students in the three profiles that the program has.
5. Regarding the profile of "Technology of drinks and water" in the fourth semester are developed only three courses "Wine", "Alcoholic beverages", "Water, Fruits, vegetables, and juices". With this limited theoretical and practical information it is difficult to prepare a specialist for the profile of "Drink and Water Technology". We believe that a solution could be to include profile courses in the third semester in order to expand knowledge in this profile.
6. Courses in both English and German occupy a large weight in the study program. Of the 4 semesters contained in the program, they are included in the first and second semesters (English 1 & English 2, and German 1 & German 2), which aggravates the curriculum with these courses and makes it impossible to include with a greater weight the characteristic courses.
7. The subject with the name "Wine" should be "Technology of wine production".
8. The subject "Water, Fruit, vegetables, and juices" should be treated separately "Fruit, vegetables" from "Water and non-alcoholic juices". Also, the addition of profile courses such as "Microbiology and Biotechnology of Wine" would serve more to increase students' knowledge on the profile of "Drink and Water Technology".
9. From the visit to the Institution it was noticed that the Department has teaching laboratories generally equipped with the most basic instruments in the field of Food Technology (performing physico-chemical analyzes of food products), but we emphasize as a necessity the separation in special facilities of the laboratory of microbiology from that of technology.

Shkalla e përmbushjes së standardeve të cilësisë së programit

| FUSHAT E VLERËSIMIT | SHKALLA E PËRMBUSHJES SË STANDARDEVE TË FUSHËS | | | |
|---|---|---|---|---|
| | Nuk përmbushen | Përmbushen pjesërisht | Përmbushen kryesisht | Përmbushen plotësisht |
| I. OFRIMI, ORGANIZIMI DHE DREJTIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMIT ME KARAKTER PROFESIONAL | | | X | |
| II. STRUKTURA DHE PËRMBAJTJA E PROGRAMEVE TË STUDIMIT ME KARAKTER PROFESIONAL | | | X | |
| III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT | | | X | |
| IV. BURIMET PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT DHE MBËSHTETJA E STUDENTËVE | | | | X |
| V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE | | | | X |
| VLERËSIMI TËRËSOR | | | X | |